

*Mehmet Halimi*

## VËZHGIME MBI TË FOLMEN E MORAVËS SË POSHTME

**Pozita gjeografike.** — Morava e Poshtme gjendet në verilindje të Moravës së Epërme dhe në lindje të Krahinës së Kosovës. Morava e Poshtme, në krahasim me Moravën e Epërme, është një regjion shumë më i vogël dhe një luginë më e ngushtë, por me një rryp toke shumë pjellore. Ky terren është më malor se ai i Moravës së Epërme. Lartësia mbidetare arrin në 1000—1300 m, pra, tokat e punuara pos rrypit të ngushtë buzë lumit Morava Jugore, shtrihen edhe në një rrafshnaltë gjeografike.


Kjo lartësi mbidetare ndikon dukshëm edhe në klimën e kësaj treve. Klima në këtë regjion është më e ftohtë se ajo në Moravën e Epërme, me vera të freskta dhe dimra të ftohtë të karakterizuar me fërfëllaza të stuhishme dhe me të reshura të pasura atmosferike. Më tepër fryjnë erërat e veriut dhe të jugut. Era e veriut sjell shira të vazhdueshme dhe borë më fërfëllazë. Ndërsa erën jugperëndimore, e cila është bukur rrymore, populli i kësaj treve e quan „Lubotenka” ose „Prizrenka”, ndërsa atë të veripërendimit e quajnë „Era e Prishtinës” ose „Prishtinka” duke u bazuar në kahjen e rrymës ajrore.

Një pjesë e mirë e këtij regjioni quhet edhe Kriva Reka ose Kriva Reka e Novobërdës,<sup>1</sup> sipas qytetit të përmendur xehetar dhe tregëtar që nga Mesjeta. Pra, me këtë emër gjeografik nënkuptohet vendi malor në veri të Moravës së Epërme. Mirëpo, në këtë studim do të lihen anash viset malore të Kriva Rekës së Novobërdës, pasi ato përbëjnë një tërësi të veçantë gjeografike e gjuhësore të quajtur me emrin Gollak. Kjo trevë gjuhësore dallohet me tipare specifike të të folurit, prandaj mund të bëhet objekt studimi në një rasë tjetër. Vetë populli në ndërgjegjen e tij ka krijuar një termin kuptimor, për një regjion të kufizuar, lidhur me Moravën e Poshtme.

Brenda këtij regjioni gjeografik populli jeton me një palë doke e zakone të përbashkëta, me një „yrnek” gjallërimi, me një mentalitet e temperament, duke i përshkuar një impuls e dinamizëm i njëjtë i tempos jetësore, e duke i komunikuar njëri-tjetrit idetë, mendimet, e nevojat e përditëshme të jetës me një të folme të përbashkët, e që në këtë rasë, këtij faktori të rëndësishëm gjuhësor, në fushën e dialektologjisë, po i vjen radha të bëhet objekt studimi.

<sup>1</sup>Atanasije Urošević, *Novabrdska Krivareka, Naselja stanovništva, Knjiga, 32*, Beograd, 1950, 3.

Kjo trevë gjuhësore shtrihet brenda këtyre kufive gjeografikë: në juglindje mbyllet me malet e Karadakut të Gjilanit, në jugperëndim me Gjilanin dhe rrafshinën e Moravës së Epërme, në veri me malet e Breznicës dhe Tërrnovcit, Karpinet, në veriperëndim me Gollakun. Morava e Poshtme përbëhet prej tri luginash të lagura nga rrjedha e tre lumenjve më të vegjël se Morava Jugore: Lumi i Hogoshtit, Krivareka dhe Lumi i Përlepnicës, e që të tre derdhen në Moravën Jugore. Këto tri luginat mund të konsiderohen si tri mikroregjione



Trevë gjuhësore e Moravës së Poshtme

të veçanta. Kështu, për shembëll, vetëm në luginën e Lumit të Hogoshtit gjenden më se pesëmbëdhjetë fshatra me një popullësi të banuar bukur dendur që arrin numrin rreth 25.000 banorësh. Ndërsa në kuptimin e ngushtë të Krivarekës, banorët e së cilës quhen krivoreçanët, bëjnë pjesë nëntë<sup>2</sup> fshatra dhe qyteza e Kamenicës. Morava e Poshtme ngërthen në gjirin e saj më se dyzet fshatra.<sup>3</sup>

Këto fshatra bëjnë pjesë në dy momuna. Numri më i madh i këtyre fshatrave bën pjesë në Komunën e Kamenicës së Kosovës, ndërsa një numër më i vogël i takon komunës së Gjilanit. Sipas regjistrimit të sivjemë, struktura kombëtare në komunën e Kamenicës është kjo: nga 46.511 banorë të saj 29.250 banorë i përkasin kombësisë shqiptare, që rrok një përqindje 62,9%, 16.653 kombësisë serbe ose 35,8%, malazez, romë e të tjerë.<sup>4</sup> Pra si shihet ky regjion është multinacional, prandaj edhe ndikimet reciproke gjuhësore janë të dukshme. Kombësia shqiptare është e përbërë prej disa fisesh dhe vëllazërish: Krasniq, Kastrat, Hot, Sop, Gash, Berishë, Thaç (Bashajt, Canajt), Kryezi (Gect, Rrudhant, Kallabtë në Rogoçicë, Morinë në Hodonovc dhe Përlepnicë) dhe Shalë. Ndërmjet këtyre fiseve dhe vëllazërive hetohen disa dallime të vogla gjuhësore, veçanërisht në fonetikë, në theksimin dhe ngjyrën e shqiptimit të zanoreve.

Popullësia e kësaj treve mirret më tepër me bujqësi, blegroti dhe tregëti. Në Luginën e Krivarekës ku toka është shumë pjellore, kultivohet: lini, kanpi e misri, ndërsa në viset më të larta gruri, thekri e duhani i kualitetit të dalluar. Rreth lumit të Përlepnicës, i cili ka gjithnjë sasi të mjaftueshme uji, shtrihen kopshte të pasura me perime të ndryshme.

Banorët e këtij regjioni të shumtën e rasave i lidhin martesat e tyre brenda kufive të Moravës së Poshtme. Janë shumë të rralla martesat me fshatrat e Moravës së Epërme. Siç shihet kemi të bëjmë me një regjion të izoluar. Prandaj kjo trevë ka konservuar trajta arkaike që mbeten karakteristikë specifike për këtë të folme.

Gjatë qëndrimit tim në terren kam vëzhguar më tepër të folmen e brezit të mesëm dhe brezit të vjetër, duke filluar nga mosha dyzet vjeçare e tutje.<sup>5</sup>

## FONETIKA

E folmja e Moravës së Poshtme në kuadrin e të folmeve shqipe verilindore nuk dallohet për tipare veçuese rrënjësore, e aq më të vogla janë dallimet me të folmen e Moravës së Epërme. Megjithëkëtë ajo ka konservuar me besnikëri disa cilësi specifike që e karakterizojnë këtë të folme, duke i dhënë një ngjyrë të veçantë lokale.

<sup>2</sup> Domorovci, Topanica, Koretini, Byrivojca, Moçari, Rubovci, Grizimja dhe Hajnovci e Rajanovci.

<sup>3</sup> Malisheva, Çopari, Uglari, Pogradja, Kmetovci, Dobërçani, Ranillugu, Kurmnjani, Domorovci, Hodonovci, Rogoçica, Novosella e Poshtme, Karaçeva e Epërme, Karaçeva e Poshtme, Muçivërca, Dajkovci, Çarakovci, Kolloleçi, Shipashnica e Poshtme, Shipashnica e Epërme, Hogoshti, Kopërnica, Straica, Grizimja, Hajnovci i Epërm, Hajnovci i Poshtëm, Moçari, Kamenica, Byrivojca, Koretini, Topanica, Drenovci, Ropotova e Epërme, R. Poshtme, Përlepnica, Kosaga, Shillova, Bozhevc, Hodëvci, e të tjerë.

<sup>4</sup> „Rilindja”, 9.V.1971.

<sup>5</sup> Në terren kam qëndruar prej 5—15 korrik të vitit 1971, ku kam zhvilluar biseda të lira me më se 50 subjekte, kryesisht të moshës së shkuar 60—80 vjeçare.

Dallimet më të mëdha në këtë të folme i ndeshim në fonetikë, e veçanërisht në theksimin e zanoreve në pozita të ndryshme shkallëzore: në fillim, në mes dhe në fund të fjalës, pastaj në fjalët njërrrokëse, dyrrrokëse, trirrokëse e më tepër, në rrokje të mbyllura, të hapura, e në pjesë të ndërduarta të ligjeratës, këto zanore shqiptohen me një theksim të ndryshëm nga trevat të tjera gjuhësore.

Pasi në një studim të shkurtër për të folmen e Moravës së Epërme<sup>6</sup> kam cekur tiparet më qenësore të së folmes së kësaj treve gjuhësore, kësaj here do të më lejohet të përfitoj nga rasti që këto dy të folme t'i konfrontoj duke i krahasuar me shembëlla përkatëse.

**Z a n o r e t.** — Edhe kjo e folme ka tri radhë zanorësh: *të gjata, të mesme dhe të shkurtëra*. Unë do të sjell shembëlla veçmas për secilën zanore në çdo pozicion.

**Z a n o r j a.** — Kjo zanore në këtë të folme është *e gjatë, e mesme dhe e shkurtër*.

*ā e gjatë* — është e gjatë më së shpeshti në rrokjet fundore të hapura si: *kalā, vllā, shkā, hatā, dynjā, belā, sefā, halā, havā, fukarā*, etj. Është e gjatë edhe në fjalët që rrokja e tyre e fundit mbyllet me likuidin *r* si: *katunār, pazār, tullār, mullār, shyptār*, pastaj fjalët me origjinë sllave: *zadrugār, pisār, govedār, bunār, por dinār, ār (5 ār tōk)*, përballë trajtës *dinār, ari (5 ari tōk, emri ari* në të folmen e Moravës së Epërme gjithmonë është në trajtën e shquar). Pra në këtë të folme thuhet: *ni dinār, dy dinār* duke mos u dalluar shumësi nga njëjësi.

*ā*-ja është e gjatë edhe në emërat neutër, si i quan Eqrem Çabej, *zāll, bāll, xhāl, māll*.<sup>7</sup> Është e gjatë edhe në këto fjalë ku është reduktuar zanorja *ē* si: *ni pār teshā, shāl, fāl, me pāl, fār, pāsh* por thuhet *shāll, fāsh* (në Moravën e Epërme *shāll, fāsh*).

Shqiptohen me *ā* të gjatë fjalët turke: *xhevāp, azāp, çitāp, hakarāt* e tjera.

Një *ā* të gjatë kemi fituar nga shpërngulja e theksit në fjalët turke si: *bakllavā, hallvā, sarmā, shakā*, në *ā* të gjatë: *bakllāv, hāvëll, sārm, shāka*,

*ā* e gjatë e ndeshim edhe tek emrat e shkurtuar të personave: *Rām, Māl, Brāh, Tāf, Hāt, Fāt, Sād*, (nga emrat: *Ramadan, Ismail, Malush, Maliç, Ibrahim, Mustafë, Hatmane* ose *Hatixhe, Fatime, Sadije*).

*ā* e gjatë e ndeshim edhe në disa mbiemra, por jo gjithherë: *i trāsh, i gāt, i bārdh* e të tjerë. Përndryshe në mbiemrat e prejardhur nga foljet do të shohim se *a* është gjithnjë e shkurtër.

*ā* e mesme — këtë zanore e hasim më tepër te fjalët njërrrokëse, por të cilat kur të shquhen fitojnë edhe një rrokje dhe bëhen dyrrrokëse. Me këtë rasë *ā*-ja e shkurtër lirohet nga rrokja e mbyllur dhe gjendet në pozitë të rrokjes së hapur, për shembëll *māli, māzi, shāti, kāli, hālli, fālli*, e të tjera.

Në emrat me *ā* të gjatë të cilët kur të shquhen kjo *ā* e gjatë shndërrohet në *ā* të mesme: *vllāvi, kāvi, shkāvi*.

<sup>6</sup> Mehmet Halimi, *Disa tipare të së folmes së Moravës së Epërme*, „Gjurmime albanologjike“, 1–2, 1970, 231–243.

<sup>7</sup> Eqrem Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe I*, Bul. Universitetit Shtetëror të Tiranës, 4, 1960, 79.

ã — e shkurtër shqiptohet në fjalët njërrrokëse të mbyllura si: *häll, fällt, mäll, mäl, päk, häk, läk, pläk, ni nät, xhäk, xhäth, vjäm*. Një ã të shkurtër e ndeshim në vetën e tretë të imperfektit: *käjke, räjke, shäjke, päjke, läjke, e mäjke*, përballë trajtave me *ä* të gjatë në të folmen e Moravës së Epërme: *räkke, shäjke, päkke, läjke, e mäjke*, e të tjera.

Një ä të shkurtër e ndeshim tek mbiemrat foljorë si: *i dälum (aj asht i dälum menç), i päsum, i dëshum, i ärdhun* përballë trajtave *i dälun (aj asht i dälun menç), i päsun, i dëshun, i ärdhun*, në Moravën e Epërme. *a*-ja në pozicion nistor ruhet gjithnjë për shembëll: ara, arra, ahi, ahër, Ahmet, Abazë, Aleks, etj. Por në disa rase në toponime ndodh që *a* nistore të bjerë *Te prroni i Lekses* (Përlepnicë), *ara e Metes*, etj. Te fjala *me agjinue* ka rënë *a* duke mos u ruajtur as togu konsonantik *ngj, pra; agjinū=ngjinū=ninū (ninimi äsht borç)*.

Në rrokjet fundore *a* gjithashtu ruhet besnikërisht pa kaluar në një *e* të shkrirë nga një *ae* e që sipas mendimit tim është një shkrirje e *ae=e*. Për shembëll *kalä, belä, hatä, dynjä, halä, nuk ka ngä* etj. Në treva të tjera të krahinës kemi: *kalë, bëlë, hatë, dynjë, dyjë, halë, nuk kam ngë*. Kjo *e* sipas Eqrem Çabejt „Pjesërisht gjatësitë kanë dalë nga kontraksioni i dy vokaleve në një vokal (ngae = nge) ose nga zhdukja e silabës mjek (medicus) dët (deubetus) *kūt (cubitus)*”.<sup>8</sup>

Kështu si në Moravën e Epërme edhe në Moravën e Poshtme ndeshim trajtat në vetën e dytë të aoristit me *ae* e që është trajtë mjaft arkaike e ruajtur që nga koha e Buzukut,<sup>9</sup> ndërsa në të folmet e tjera të krahinës e të mbarë shqipë nuk ruhet. Në të folmen e Moravës së Poshtme thuhet: *ti pae, rae, thae, lae*, e nganjëherë për të prishur hiatusin në mes togut vokalik *ae* hyn një vepentetike: *ti pave, rave, thave, lave*, etj., përballë trajtave të të folmeve të tjera shqipe: *ti pë, rë, thë, lë*. Trajta këto të përqafuara edhe nga gjuha letrare, *ä* e shkurtër në këtë të folme është *a* e pastër orale: *mäl, mätz*, pastaj edhe kur është e gjatë apo e mesme gjithnjë kemi të bëjmë me një *a* orale pa kurrfarë nuance të ndonji vokali tjetër: *fäl, Ramadani*, ndërsa në trevat kufitare të kësaj të folmeje, në Gollak hetojmë një ä jo të pastër, por të përzier me nuanca të një *o*-je si: *mäl, fäl, Ramädani*, etj.<sup>10</sup> *A*-ja te foljet ndihmëtare apo të mikonjugacionit kalon në *o*: *kom, jom, thom*.

*A*-nga njëherë kalon në *e* si: skej (skaj), masanej, (masânaj); nemi (namë), kafez (kafaz), sej (saj).

*Zanorja e*: poashtu mund të jetë *e* gjatë, e mesme dhe e shkurtër.

*E*-në e gjatë e ndeshim të fjalët me rrokje të hapura si: *dhë, fë, bë-ja, me blë, me prë*, etj. Është e gjatë edhe te emrat e shkurtuar të personave si: *Zëk, Zëç, Xhëm, Hëm, Mët, Fët, Lët* (nga emrat: Zeqirja, Xhemail, Muharrem, Ethem (i di Heta punt e veta), Ahmet, Mehmet, Fetije, Letafete).

*E*-e mesme gjendet te emrat e shquar të cilët në trajtën e pashquar këtë *e* e kanë pasur të gjatë, për shembëll: *feja, dhevi, beja, rrufeja*, pastaj te fjalët turke te të cilat theksi është shpërngulur: *séfte, dýsheme, híle, híse* në vend të *sefté, dyshemé, hilé, hisé*,<sup>11</sup> e të tjera.

<sup>8</sup> E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1970, 113.

<sup>9</sup> Dr. Idriz Ajeti, *Historia e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1969-89.

<sup>10</sup> Ë me përjete drejt një *e*-je me nuanca të *o*-së që mund të shënojmë *oë*.

<sup>11</sup> Eqrem Çabej, *Studime rreth, etimologjisë së gjuhës shqipe*, Studime filologjike, 3, 1965, 54.

E të shkurtër kemi në pozitë të rrokjeve të mbyllura në fjalë, e veçanërisht të fjalët njerrokëse si: *çën, vën (vënd), sën (sënd), prës, shës, mën, dhën*.

Në fjalët turke e-ja është e shkurtër si: *bët, fët, bëg, zëvk, xhenët, hyçmët, kysmët, kjamët, alamët, zahmët, rahmët, marifët* etj.

E-ja është e shkurtër te mbiemrat cilësorë si dhe te mbiemrat foljorë, për shembëll: *i nxët, i drëjt, i shpëjt, i shtrëjt, i lësht, i thërrum, i dëshum, i pjëkum*, për ballë trajtave me *ë* të gjatë në Moravës e Epërme: *i nxët, i drëjt, i shpëjt, ishtrëjt, i thërrum, i dëshum, i pjëkum*.

Pasi jemi duke e shoshitur problemin e e-së nuk duhet të lëmë në këtë rast pa përmendur tipin e një e-je të çelur që nuk e ndeshim në të folmen e Moravës së Epërme, e madje nuk është e shtrirë në të tërë të folmen e Moravës së Poshtme, por vetëm në një grup fshatrash: Rogoçicë, Hodonovc, Dajkovc, Koretin dhe Përlepnicë e shumë pak edhe në Malishevë. Kështu në fjalët: *keçri, theërra, zhgëdha, mushërra*, pastaj te foljet: *me mjëll, me pjëll, me vjëll, me vjëdh*. Te emrat foljorë: *mlëdhje, vjëdhje, vjëllje, pjëllje*. Është interesant se kjo e çelur nuk humb kurrë intensitetin e theksimit as gjatë lakimit e as gjatë zgjedhimit të pjesëve të ligjeratës. Qe për shembëll: *theërra, theërrë, theërrës, theërrën, theërrës*.

Prezenti: *vjëdhi, vjëdh, vjëdh, vjëdhmi, vjëdhni, vjëdhin*.

Aoristi: *vjëdha, vjëdhe, vjëdhi, vjëdhëm, vjëdhët, vjëdhën*.

Perfektii: *kam vjëdh, ke vjëdh, ka vjëdh, këna vjëdh, këni vjëdh, kanë vjëdh*.

Në shembëllat e mësipërme ndeshemi me një e të shqiptuar njësoj si te fjalët frënge: *frër, për, mër*.<sup>12</sup> Këtu e-ja paraqet një tendencë diftongizimi në *ie*. Fjalët *me hjek, me dek*, bëjnë përjashtim nga ky lloj shqiptimi. Këtë fenomen fonetik e ndeshim edhe në të folmen e Kaçanikut me rrethinë.

G j y s ë m z a n o r j a ë. — Nuk mundemi të bëjmë fjalë për kualitetin e kësaj zanoreje, por le të shohim ruajtjen e saj në pozita të ndryshme të fjalës. Pra, *ë* nuk mund të jetë: *e gjatë, e mesme* e as *e shkurtër*, madje nuk mund të bëjmë fjalë as për nazalitetin e saj. Shi për këtë, duke i munguar këto cilësi që posedojnë zanoret e tjera, këtë zanore e kemi quajtur gjysmëzanore.

Ë-ja në mes të fjalës nuk ruhet gjithënjë, por vetëm kur gjendet para likuideve: *l, r, rr* dhe *ll*. Si: *i vogël, püpël, thüpër, këkërr, i vocërr, akëll, vëtëll, pëtëll*. Ndërsa në këto fjalë ë-ja nuk ruhet: *kmësh, me knü, knüs, knim*. Në disa rasa ë-ja kalon në e si për shembëll: *nanes, babes, motres* (e jo si në Llap: *babs, nans, motrs*), analogjikisht me fjalët *nuses, tezez, lules, delmes*, e tjerë.

Në raste kur emri merr mbaresën -s në gjenitiv, dativ dhe ablativ, ë-ja kalon në e për shembëll: *nanes, babes, motres, tezes, halles* (nanes teme, babes tem, etj.) e nuk zhduket krejtësisht si në të folmen e Llapit, Drenicës, Shalës së Bajgorës<sup>13</sup> e në disa treva të tjera gjuhësore të krahinës ku ndeshim trajtat: *nans, babs, motrs, halls, (nans teme, babs tem)*.

Në disa raste ë-ja kalon në i, thuhet: *me xhimü, (nga gjamë, gjëmue, gjimue), me çinrü (qindroj), me lishu, me likun(d)*, por edhe *lkun (se lkuni komen), likur, livore, lishoj, lipij, filçi* etj.

Ë-ja kalon në u në fjalët: *shkelum, i vetum, i hershum, i vonshum, i moçum, i lodhshum, i unshum, i etshum, i metshum*.

<sup>12</sup> Mehmet Halimi, *punim i cituar*, 232.

<sup>13</sup> Dr. Latif Mulaku, *Mbi të folmen e Shalës së Bajgorës*, Jehona, 7—8, 1969, 68.

Prapashtesa turke *-llək* shqiptohet *-llak* e në disa vende si Hogosht dhe Luginën e Lumit të Hogoshtit si *-llok: agallak, harçllak, kallabllak (kallaballak), çifllak*, por edhe *kallabllok, haxhillok*, etj. Ndërsa prapashtesa *-ək* shqiptohet *-ak, sanak (sandak)*.

**Z a n o r j a i.** — Edhe kjo zanore mund të jetë tri llojesh: e *gjatë, e mesme dhe e shkurtër*.

I të gjatë më tepër ndeshim në rrokjet fundore të hapura si: *liri, shpi, çikni, rini, nusni, shi, pleçni, burrni, shoçni, miçasi*. Kjo zanore është e gjatë edhe në fjalët që kanë hyrë përmes turqishtes: *jabanxhi, axhami, suhari, asçeri, mexhedë, mejtepli, haxhi* etj.

Pas një *i*-je të gjatë në fund të fjalës kur kjo pëson lakimin nëpër rasë del një *j*, si: *mik i shpiçs, jabanxhiçs, liriçs, Jugosllavijes, S'ypnijes*, etj.

I është e gjatë edhe te disa mbiemra foljorë: *i pim, i nxim, i mërdhim, i ngim, i thim*, përballë trajtave të laryshta në të folmen e Moravës së Epërme: *i pin (i pim), i xin (i nxim), i mërdhin, (i mërdhim), i ngin (i ngim), i thin (i thim)*.

I është e gjatë nga një herë edhe në fillim të fjalës sidomos tek emrat e shkurtuar të njerëzve: *Is, Ib, Il*, (Isah ose Isak, Ibrahim, Ilmi). Zanorja *i* është e gjatë te fjalët ku është reduktuar *ë*-ja, si: *i mir, lir, kmish, pish, me fik, pik, me pik, kthiz, fshis*.

*I e mesme* — më tepër e ndeshim te emrat e shquar të cilët *i*-në e gjatë e shndërrojnë në *i* të mesme: *pish-a, dita, pitja, çika, e prita, e pita ujin, e fika shpijen, e shita kavin* etj.

*I e shkurtër* — më tepër është karakteristike për fjalët një rrokëse të mbyllura e shumë rrallë për fjalët me rrokje të hapura: *mish, drith, fish (nga fillsh), fis, fiç, mik, brisk, oriz, xhiz* (në Moravën e Epërme xhiz).

I-ja është e shkurtër edhe te fjalët te të cilat është shpërngulur me kohë theksi nga rrokja bazë e fjalës ka kaluar në sufiks, si: *kokrriz, morriz, puliz* (nga fjalët: *kokërr, morr, pulë*, khs. me fjalët *unaz, këlbaz*.<sup>14</sup> *i* të shkurtër e gjej-më edhe në sufiksin *-nik: fisnik, besnik, shpijanik, mexhenik, fllanik, rasenik, minik, shinik* etj.

I-ja është e shkurtër edhe te mbiemrat foljorë për shembëll: *i th'rrum, i lidhum, i virum, i nisum*, përballë trajtave me *i* të gjatë në të folmen e Moravës së Epërme: *i thirrun, i lidhun, i virun, i nisun*. Fjalët me origjinë turke e me rrokje të mbyllur shqiptohen me *ï* të shkurtër: *myderriz, meçliz, pis*.

I-ja nistore në disa emra njerëzish e nga njëherë edhe në toponime bie krejtësisht, për shembëll: *Smajl, Brahim, Cuf, Lam*, (Ismail, Ibrahim, Isuf, Islam), Zmornik (Izmornik — emër lokaliteti në Moravën e Poshtme, *i* cili përfshin një grup fshatrash, khs. me *Nagllav, Legllav*, në Moravën e Epërme).<sup>15</sup> Vokali *i* i shtohet foljeve në vetën e parë të prezentit si: *unë lidhi, hapi, kapi, shkuni, lkuni, foli, por jap (ap), dal, e jo japi (api), dali*.

**Z a n o r j a o.** — *Ö*-në e gjatë e ndeshim nga ndikimi i *ë* së zhdukur në rrokjen e fundit *bõt, tøk, ök, dör, u banëm hör, möll, böll, fjöll, shköll*.

<sup>14</sup> Eqrem Çabej, *Hyrje në Historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1970, 102.

<sup>15</sup> Mehmet Halimi, *punim i cituar*. 239.

*Ō*-ja është e gjatë te mbiemrat cilësorë: *i hōll, e hōll, i fōrt, e fōrt, i plōt, e plōt*. Foljet në infinitiv: *me fōl, me kōn, me kōll, me hōrēr*. Fjalët sllave: *vojvōd, pōll, ni pōll* (nga sllav. *pola*).

*O*-ja e mesme: nën ndikimin e mbaresës së shquesisë fjalët me *ō* të gjatë si dhe ato me *ō* të shkurtër kthehen në *o* të mesme për shembëll: *toka, molla, bolla, fjolla, vorri, morri, kōlli, etj*.

*Ō*-në e shkurtër e ndeshim në fjalët me rrokje të mbyllura si: *zōg, shtōg, lōt, kōsh, obōrr, çōrr, mōrr, vōrr*. Në ndajfolje mënyre: *hōll, plōt, hōsh* (i erdh hōsh), *fōrt* (po dalke lavra fōrt), *ftōft, kām me lōt*.

Emrat: *lōpt* (Udha e Lōpve — Hogosht); *flōkt*, shqiptohen me *ō* të shkurtër, ndërsa në Moravën e Epërme me *ō* të gjatë: *lōpt flōkt*. Mbiemrat cilësorë gjithashtu shqiptohen me *ō* të shkurtër si: *i vōgël, i mōçum, e pōshtme, i fōlum*, në vend të trajtave: *i vōgël, i mōçum, e pōshtme, i fōlum*, në M.Epërme.

Vlen të vihet në pah se *o*-ja në këtë të folme është orale, ndërsa në viset malore të Gollakut, i cili dallohet në mënyrë shumë të prerë, duke u ngritur në zgrip të fshatrave Hogosht dhe Shipashnicë e Epërme hetojmë një *o* që anon nga gjysmëzanorja *ē* e që do ta shënojmë me shenjën *ō* për shembëll thuhet: *lōp, tōk, mōll, bōll, e të tjera fjalë të ngjashme me këto*.

**Z a n o r j a u.** — Kjo zanore është e gjatë te fjalët te të cilat është reduktuar *ē*-ja në rrokjen fundore: *pūl, fūsh, ūr, me mūsh*. Pos kësaj është e gjatë *ū*-ja e monoftongizuar nga *ue=ū* për shembëll: *me punū, me shkū, me livrū*, etj. *ū*-n e gjatë e ndeshim edhe në fjalët ku dikur është reduktuar një rrokje si *kūt* (*xhasht kūt xhguna shkōjn për ni pār tirçi*) nga *cubitus*.

*U* e mesme: *lugi, jugi, pllugi, shuli, fusha, e luta, e ruja, buja*.

*U*-në e shkurtër — e ndeshim në fjalët njërrrokëse dhe në fjalët me rrokje të mbyllura: *hūt, pllūg, jūg, lūg, shūl, pūs, knūs, çūll, grūn, xhūm*. Ndërsa në Moravën e Epërme fjalët e fundit shqiptohen me *ū* të gjatë: *knūs, çūll, grūn, xhūm*. *Ū*-ja është e shkurtër te mbiemrat si: *i shkūr* (rrena i ka komt e shkūrta), i ngūsht (aj â njeri i ngūsht) krahaso: *i shkūr*, *i ngūsht* në të folmen fqinje. *U*-ja para *ll*-s dhe *r*-s që mbyllin rrokjen e fundit të fjalës kalon në *ē*, për shembëll: *petēll, vetēll, kumēll, sumēll, sjetēll* (bukën nërsjetell, plisin përmi vetēll), *lepēr, hekēr*, në vend të trajtave: *petull, vetull, kumbull, sumbull, sjetull, lepur, hekur*. Kjo *u* e patheksuar, e cila është shndërruar në *ē* në trajtën e pashquar, në trajtën e shquar, bie krejtësisht dhe kemi: *petlla, vetlla, kumlla, sumlla* (i shkojshin lōt si sumlla, i horjër paret rrush e kumlla), *sjetlla, lepri, hekri*. Format më besnike që rrojnë përherë në gojën e shqipfolësve të kësaj treve janë edhe toponimet, si: Te Gūrt e Akllit (Muçivërc), Te Veṭlla (Karaçevë e Epërme), Te Lisi i Veṭlles (Rogoçicë). Nganjëherë një *u* e emrave, kur kalon në folje, kthehet në *i*, nga emrat: *luftē, lule* fytyrëzohen foljet *me liftu, me lilu*, (at dit kena liftu xhithditën, kan lilu pemt).

**Z a n o r j a y.** — *Y*-ja është e gjatë nën ndikimin e *ē*-së së reduktuar, diftongut *ye* si dhe te fjalët në rrokje të hapura: *ftȳr, ynȳr, me mȳr, frȳm, drȳ, sȳ, pshtȳm, i ngjȳm, i lȳm, tlȳn, pȳll* (e cila përdoret shumë rrallë), *shȳptar, shpȳrt*, te emrat e personave: *Hȳs, Hȳr, Xhȳm, Xhȳl*, etj. Fjalët me origjinë turke: *mȳhyr, mȳfti, mȳderriz, mȳshteri, mȳtesarif*.

*Y* e mesme: *tlyni, dryni, fryni, shpyrti, shyptari, pyk* etj.

ÿ e shkurtër paraqitet në fjalët njërrokëse si dhe në fjalët me rrokje të mbyllura: *tÿm, mÿshk, mÿk, klÿsh, fÿll* (blejma ni fÿll), *tÿmën, M.E. fÿll, tÿmën*. Fjalët e huaja të hyra nëpërmjet turqishtes: *çÿfër, mÿlk, yklÿk, hÿçm, mÿhlet, kÿsmet, rÿshfet*, etj.

Në këtë trevë gjuhësore *y*-ja ruhet besnikisht në çdo pozicion të fjalës, ndërsa në viset kufitare në verilindje, në fshatrat e rrethinave të Bujanovcit *y*-ja kalon në *i*: *di, sini, filli, tlini, frini* (era).<sup>16</sup> Në të folmen e Moravës së Poshtme bën përjashtim vetëm fjala *me hi, hini*, në vend të *me hy, hyni*, pastaj fjala *kysmet* nga njëherë shqiptohet me *i* kismet, si dhe disa emra të personave paralelisht me trajtat me *y* *Ymer, Hysen, Yzer*, ndihen edhe me *i*: *Imer, Hisen, Izer* (gjë e cila ndodh nën ndikimin e serbishtes, por gjithmonë me *y* emrat: *Xhymshit, Hysni, Hysnije, Hyrije, Xhylije*).

Diftongjet në këtë të folme nuk ruhen me besnikëri. Thuhet: *me punū, me shkū, me thÿ, me përzl, me mū, me tÿ, me krÿ*, etj, por *eja me mue, u msove pi mue, pi tye e mora kët msim, n'dash me punū, puno, ruju se po shkon me krye, shkun krÿ për krye*, e të tjera shembëlla ku diftongjet ruhen në rasi të veçanta sipas rëndësisë së fjalës që zotëron në bisedën e dy shqipfolësve. Ndërsa togjet zanore *ae* dhe *oe* ndjekin të njëjtën rrugë gjatë shqiptimit të fjalëve në pozicione të ndryshme si në të folmen e Moravës së Epërme.<sup>17</sup> Pra, kemi trajtat: *ti lae, pae, thae, rae*, ku nga njëherë ndeshim një *v* epentetike si: *lave, i rave, e pave, i thave. Ti i rave përpara. M'pave çu po vi edhe ike. Pse i thave rri te shpija*. Ndërsa togu zanor *oe*, që në të folmet toske para migrimit të Arbëreshëve të Greqisë në Itali në shek. XIII dhe XIV është kontraktuar në *e*. Më vonë në të folmet veriore, veçanërisht në shkodranishte dhe në të folmen e Kastratit,<sup>18</sup> ky grup u kontraktua në *o* si për shembëll: *vō voe, vōsa voesa, rō roe* e të tjerë. Ndërsa në të folmen e gegërishtes jugore kemi një *e* pak më të gjatë se sa në atë të toskërishtes: *ve<voe, re<roe, ves<voes*. Ndërsa në të folmen e Moravës së Poshtme është ruajtur grupi arkaik i vokaleve *oe*: *droe, voe, mos rri pa droe, pula bon voe* (khs. me dokumentin më të vjetër në Kosovë).<sup>19</sup> Togu zanor *oe* ruhet edhe në vetën e dytë të prezentit në mënyrën urdhërore: *kërkoe, knoe, punoe, harroe, livroe, lishoe, çoe*: *kërkoe mishin a ka kryp boll! Knoe letren tani kallxoma shka po thot! Punoe punën si duhet e mos bon hile! Harroe t' keçen e lyju xhallnimit! Livroe çet razūr tani lishoj kijet n'drek! Ja lishoe ja maje si duhet!*

Nazalizmi — në këtë të folme të gjitha zanoret, me përjashtim të gjysmëzanores *ë* nazalizohen. Nazalizmi siç dihet shkaktohet nga prania e bashkëtingëllores buzore *m* dhe dhëmbore *n* përpara zanoreve përkatëse, por nga njëherë nazalizmi shkaktohet edhe në bazë të analogjisë. Shembëlla fjalësh të nazalizuara me *â*: *me bâ, me fshâ, zâ, me lân, me dhân, mullâ, xhâ-ja, me prâ, i prât, vrât, me ciât, fllâz*.

Ë-ja e nazalizuara: *frê-ni, pê-ni, me rrêjt, mêjti* (era, dhimta),

<sup>16</sup> Dr Idriz Ajeti, *Rreth disa veçorive të të folmeve të rrethit të Preshevës dhe Bujanovcit*, Gjurmime albanologjike, 2, 1969, 43.

<sup>17</sup> Mehmet Halimi, *punim i cituar*, 235.

<sup>18</sup> Gjovalin Shkurtaç, *E folmja e Kastratit*, Studime filologjike, nr. 3, 1967, 39.

<sup>19</sup> Dr Idriz Ajeti, *Najstariji dokument kosovskog arbanačkog govora na arapskom pismu*, Gjurmime albanologjike, 1, 1962, 24, 25.

i-ja e nazalizuar: *hi-ni, tpi-ni, li-ni, m'u th'i, ti-ja, shklli-ja, me pi, me pri, mërddhi, mulli, fi-ni, fi-ja*. Analogjikisht me këto kemi: *kaci (lopate), fli, thmi, thni, mi-ni* (nga mus-muris), *tatli, mushkni, fshis, kus, me ki, kthiz*.

O-ja e nazalizuar — kjo zanore nazalizohet shumë rrallë megjithëkëtë nuk mungojnë krejtësisht shembëlla hundorësimi si *akshôm, dôm, shôm* (lat. scamnum) *dhôm, pllôm, me kôn, jôm, kôm*. Mirëpo intensiteti i nazalimit në këto fjalë është mjaft i dobët.

y-ja e nazalizuar: *shllung, drû-ni, hû-ni trû-ni, gû-ni*, analog me këto shembëlla kemi edhe *gûha, frûth-i, skûth-i*.

Y-ja e nazalizuar është mjaft e shpeshtë: *drÿ-ni, sÿ-ni, me frÿ, me shfrÿ*.

Kemi edhe shembëlla denazalizimi si: *kâlli* (nga kâlli-ni), *i gryt* (nga grun, i grunjt, i grynjt, i gryt), etj.

### Bashkëtingëlloret

Sistemi bashkëtingëllor i së folmes së Moravës së Poshtme dallohet shumë pak nga ai i së Folmes së Moravës së Epërme, ndërsa ka disa pikëlargime më të mëdha nga e folmja e mbarë krahinës së Kosovës dhe të folmes veriore të mbarë gegërishtes. Tani le të shohim konkretisht duke parashtruar shembëlla nga kjo e folme.

**Bashkëtingëllorja h.** — Kjo bashkëtingëllore në të shumtën e rasave ruhet besnikërisht si në fillim të fjalës, në mes dhe në fund; për shembëll: *Hasan, hajn, hekër, hun (hund), me hërr, hec, por me ik; shihet krehet, lahet, krah, ah, pleh, me njeh*, etj. Fjalët me origjinë turke shqiptohen gjithashtu me *h* si: *hatër, hazër, habdall, hardall, hajvan, havadÿz, hise, hile, hõxh*, etj. *h-ja* shpesh shkëmbehet me *f*; thuhet *e njõh, por i njõftum, e njõfta*, e rrallë herë edhe *e nxhõfta* (Hogosht), ftoft. Një *h:f* ndodh edhe në gjuhën letrare si: *hlad: fllad*. Alternimi *h:f* rëndomë bëhet pas vokaleve të mbyllura.<sup>20</sup>

*H-ja* mund të paraqitet edhe si tingull epentetik si në fjalët: *me hëc, me hik, hunxhu, hapasuz* (turq. apansëz), *Hesat* (Esat), si dhe tek ndajfoljet vendore: *i ktuhit, ktuhja, i açehit, açehja, çekjohja (e kom dit ç i çekjohja m'xhon), ktuhja e çoj, po açehja s'e mür, pi shkahit je lig?*). Faringali *h* hyn në mes të fjalës si *h* antihiatizuese në foljet pasive dhe refleksive si: *dihet, munohet, lahet, lyhet*, e të tjera.

*H-ja* në fillim të fjalës kur gjendet para *j-ës* nuk ndëgjohe për shembëll: *jeks-i, me jëk, jëkat kurr s'harrohen, krasat* (kracat) e kerit nga: *hjek-i, me hjekë, hjeka, krahsa*, etj. Nuk dëgjohe edhe në pozicionin memor, kur gjendet para labiales *m: nim-a, me nimû, nimim, i nimova*, pastaj tek emrat e njerëzve: *Amet, Memet, Belul* etj. Në disa fjalë turke *h-ja* kalon në *sh* si: *bashçevanxhi, boshçe, boshçellak*, nga: *bahçe, bahçevanxhi, bohçe, bohçellëk*.

*H-ja* para dentalit *t* gjithashtu nuk dëgjohe ose dëgjohe, por shumë e dobët: *lët, i lët (është i lët ka xhumi), i nxët, nxët, i fshët, i sprët* (në vend të: *i lehtë, i mëshehtë, i mprehtë, i nxehtë, etj.*). *H-ja* ruhet edhe në mbarim të fjalëve

<sup>20</sup> Dr Idriz Ajeti, Po aty fq. 38.

si: *ah-i, krah-i, niçah-i, xhynah-i*. Mirëpo te disa emra njerëzish *h*-ja në fund ka rënë si: *Avdulla, Sali, Hajrulla*.

V e l a r e t, *k, g*, ruhen besnikërisht në çdo pozicion të fjalës si në fillim, në mes dhe në mbarim (khs. me të folmen e M. Epërme).<sup>21</sup> Velari *k* në fjalët turke dhe arabe në të shumtën e rasteve palatalizohet: *ashiqare* (tur. *ashikare*), *beqar* (bekar), *Çabe* (Kabe), *çafir*, *Çamil*, *Zeçir*, por *Zëk*, *Zëq*, *Zëqat*, *Çerim*, *todoruç* (tederuk), *mubareq* (mubarek). *K*-ja nuk palatalizohet para *m* labiale p.sh. *tekmil*, ndërsa para *b*-s ndeshet në dy varianta: *tekbir* < *takbir*, *teqbir*. Një *k=q=ç* e ndeshim në singular te fjalët: *shoç* (shoq=shok), *fiç* (fik). Këtu shihet qartë se kemi të bëjmë me singularizimin e pluralit. Këtë dukuri e ndeshim në Lumë, Mat, Tetovë, Kosovë. *G*-ja në shumës para vokalit *e* palatalizohet në *xh* si: *varg-varxhe*, *burg-burxhe*, *pllug-plluxhe*, *lug-luxhe*, *breg-brexhe*, ndërsa *shtek*. (*shtege*)=*shteqe*. Fjalët turke shqiptohen me *xh* si: *xhaur* (turq. *gaur*), *xhevrek* (turq. *gevrek*), *xherfshek* (turq. *gevshek*).<sup>22</sup> Mirëpo: *dizgina*, *legen*, *zengin*. Në fjalën *i vacërr* *g*-ja është asimiluar në *k* el në *r* (*i vogël=i vokël=i vocël=i vocër=i vacër*).

B a s h k ë t i n g ë l l o r e t: *q, gj* dhe *ç, xh*. — Në këtë trevë gjuhësore pothuaj në tërësi ashtu si në të folmen e Moravës së Epërme qiellzoret *q, gj* kanë kaluar në afrikate paraqiellzore *ç, xh*. Mirëpo unë kam cekur se në gjysmën e fshatrave të Karadakut të Gjilanit dominojnë qiellzoret *q, gj*, ndërsa në fshatrat e rrëzës juglindore zotërojnë tipe të *q, gj*, tepër të buta që gjenden në mes të një *k-j, g-j*, kurse në fshatrat e rrethinës së Kumanovës qiellzoret e buta nën ndikimin e maqedonishtes gati kanë kaluar në *k, g* e veçanërisht *q*-ja, për shembëll shqiptohen me *k* fjalët: *me këth*, *ushkim*, *shkip*, *kimir*, *ing-je*, në vend të: *me qeth*, *ushqim*, *shqip*, *qymyr*, *ingje*. Duke u nisur nga fshatrat e rrethinës së Kumanovës e duke shkuar luginës së Moravicës gjer ke fshatrat e Komunës së Bujanovcit, Lluçan e Konçul, gjithkund ndeshim në të folur, qiellzoret *q, gj*. Kjo rrymë gjuhësore pastaj ka hyrë thellë dhe në Moravën e Poshtme gjer ke fshatrat Hodonovc, Rogoçicë, Muçivërc, e shumë pak hetohet edhe në Hogosht. Pra, në luginën e Lumit të Hogoshtit ndeshemi me qiellzoret që shqiptohen të nuancuara në mes të *q, gj*, dhe *ç, xh*. Gjer në Rogoçicë më tepër anojnë kah *q, gj*, se sa *ç, xh*, ndërsa në Hogosht më tepër anojnë në drejtim të *ç, xh* se sa *q, gj*. Kjo dukuri është influencë e fshatrave të Moravicës nëpërmjet lidhjeve martesore dhe tregëtare. Përndryshe në tërë Moravën e Poshtme janë në përdorim vetëm afrikatet *ç, xh*, ashtu si edhe në Moravën e Epërme dhe mbarë të folmet e krahinës së Kosovës. Shqiptohen me *ç, xh* fjalët: *çën*, *çill*, *i kûç*, *xhâth*, *xhÿs*, *xhârpën* etj. Grupi *shq* e *shç*, nuk ruhet: *yshym*, *shyptar*, *shyponj*.

Duhet ndarë si tipar veçues, të ngjashëm me të folmin e Moravës së Epërme se edhe këtu kemi të bëjmë me afrikatet *ç, xh* që janë një shkrirje e tingujve *tj, dj*, *tj=ç* dhe *dj=xh*, kjo është rregull ku nuk na paraqiten përjashtime, thuhet: *çeter*, *açe*, *i açehit*, *xhûm*, *xhâth*, *xhâl*. Por këtu vlen të përmendet se *tj* është rrafshuar në *ç* edhe në fjalën *tjerr-i*, *me tjerr*, *shka po tjerresh*,

<sup>21</sup> Mehmet Halimi, *punim i cituar*, 236.

<sup>22</sup> Abdulah Skalić, *Turcizmi u srpskohrvatskom jeziku*, Sarajevo 1966.

siç bën përjashtim në Moravën e Epërme, ndërsa këtu, në të folmen e Moravës së Poshtme, ballafaqohemi me trajtat: *çerr-i, me çërr (Përlepnicë e çërrin ma holl) shka po çërresh?* Në këtë rasë duket se ç-ja është e ndjekur nga një *j* e pahetueshme, e cila humb nga forca e zgatjes së një *e-je* të çelur, *çërr, me çërr, (shka po çërresh?)* Ndërsa *dj-xh* për shembëll: *xhë, xhëp, xhàth, e xhëga, u xhëge, u xhëg, xhëm* (në vend të *dje, djep, u dogja, u dogje, u dogj, djem, djelm*). Mirëpo *njers (djers)* Këtu dikur ka qenë *ndjers, d-ja* ka rënë = *njersë* si *ndjefsha = njefsha, me ndjek = me njëk, me ndjell = me njëll e me nill*, ku grupi konsonantik *ndj* ka dhënë *nj*. Në të folmen e Tetovës kemi *gjers, gjersohem*.<sup>23</sup> Këtë dukuri *tj = ç* dhe *dj = xh* e ndeshim edhe në të folmen e Zall-Dardhës,<sup>24</sup> në Shqipërinë e Mesme<sup>25</sup> dhe në një pjesë të gegërishtes verilindore, të folmën e Tetovës

Një *ç* e ndeshim të prejardhur nga *t + sh = ç* si: *paç, i moçum, i gaçum, viç*,<sup>26</sup> (por shumësi *vjeta*), *veç e veç, sa vjeç, etj.* por kurrë nuk ndeshim trajtat: *i soçëm, i gaçëm, i përdiçëm, i mërziçëm*, siç bëjnë të folmet e toskërishtes dhe gegërishtes verilindore,<sup>27</sup> por mbetet *tsh: i sodshum, i gatshum, i përditshum, mërziutshum (sod dishka jam mërziutshum)*.

**Bashkëtingëllorja nj.** — Bashkëtingëllorja *nj* nuk bën lajthitje të mëdha nga e folmja e Moravës së Epërme. Në raste më të rralla, jo të mëdha nga e folmja e Moravës së Epërme. Në raste më të rralla, jo në të tërë tërë e Moravës së Poshtme, pas *nj-së* shpifet një *xh*, për shembëll: *e nxhof, e nxhofia* (Hogoshit), kurse numërorin themelor *një* e kemi si *ni*, e kur lakohet përsëri del në shesh *nj-ja, njôni, (njôni-çëtrit ja dhan besen)\** thuhet i *xhelpt (për i njelmët)* fjalë të cilën e ndeshim edhe në toponime si: *Kroni i xhelpt, Xhelbsina* (Përlepnicë). Ndërsa në rasta të tjera gjithnjë ruhet *nj-ja* si: *njërku, njerzi, njerthi, njëri, me njëfi, i njôm, njëll* etj. *Nj-ja* nuk ruhet si sufiks në emra fisesh: *Gashjan, shaljan, sopjan, thaçjan*, e jo *gashnjan, shalnjan, sopnjan, thaçnjan*.

**Bashkëtingëllorja j.** — Ky tingull ruhet në të gjitha pozicionet strukturale të fjalës, por nuk mund të përjashtohet dukuria e tij si tingull epentetik e shumë rrallë mund edhe të bjerë krejtësisht: *jap (ap), jep (ep), japmi (apmi)*. Edhe në këtë të folme e gjejmë të pranishme në veten e tretë të imperfektit të foljeve konsonantike: *lájke, thájke, thojke, májke, hájke, rájke, pájke*, (por edhe *hanke, rakke, pakke*). Në këtë të folme pas një *i-je* të gzatë lind një *j* për shembëll: *pi pleçnijos, pi Shypnijos, n'vakt Turkijos, i faist* (i dobët nga shëndeti), por *i fajisum, jesir* (esir), *jorgovan* (argovan).

*Lj-ja* sllave edhe në këtë të folme kalon në *j* e kryesisht në toponime, si: *Lipjan-i, Ramjan-i, Llabjan-i, Kurmnjan-i* (fshat në rrjedhën e Lumit Krivareka),

\* Vërejtje: Fjala *njo* në këtë trajtë përdoret kur është në funksion të numërorit themelor, ndërsa kur të shërbejë si nyje gjysëmshquese përdoret *ni*: *Erđi ni njëri, e pash ni zhal*. Të njëjtën trajtë e ndeshim edhe në numërorët: *nimđhet, nizeť, nićin* etj. Mirëpo të numërorët të të cilët *njo* paraqitet si element i dytë i numërorit është ruajtur palatali *nj*, si p. sh.: *nizetenjo, trichetenjo* etj.

<sup>23</sup> Remzi Nesimi, *Fonetike karakteristike albanskog govora Tetovske okoline, 1971*, (punim magistrature — dorëshkrim)

<sup>24</sup> Bahri Beci, *E folmja e Reç Dardhës së Dibrës*, Studime filologjike, 4, 1964, 149.

<sup>25</sup> Anastas Dodi, *Fonetika e gjuhës së solme shqipe*, Prishtinë, 1970, 22.

<sup>26</sup> Eqrem Çabej, *vep. e cit.* 138.

<sup>27</sup> Anastas Dodi, *vep. e cit.* 21.

*Ramidëj*, përballë trajtave sllave: *Lipljane, Ramljane, Labljane, Kurmljane, Ravnidel* etj.

**B a s h k ë t i n g ë l l o r e t l, ll.** — Në këtë të folme nuk mund të bëjmë fjalë për një *l* ose *ll* të mesme. Këtu dallohen qartas sipas intensitetit të tyre *l*-ja nga *ll*-ja. Pra, kemi të bëjmë me një *l* të butë dhe *ll* të fortë, për shembëll: *lul-a, pül-a, shül-i, me mjël, lipetra, letër, lepër, llüg-a, llüll-a, püll-a, shllüng-a, lloç-i, mall-i, källi, ni källi, (shumësi kajzi, yjzi, ni ýz, klýzit, kimzit)*, forma që nuk shprehin deminutivin e emrave: *kalli-ri, yll-i, klysh-ëz, kime-kimëz, bollëza, sorza*, etj. por shprehin kolektivitetin e tyre.

*ll*-ja nga njëherë shkëmbehet me *dh* sidomos te përemri pyetës: *cidhi (cidhi ke aj çl ta mshoj), me vjell* (Përlepnicë) në vend të foljes *me vjèdh*. Këto rase sporadike nuk janë të shtrira në të tërë këtë regjion sa të mund të flitet për to si një dukuri e veçantë gjuhësore e kësaj treve.

**B a s h k ë t i n g ë l l o r e t r, rr.** — Ruhen besnikërisht dhe nuk mund të flasim se ekzitojnë tipare veçuese nga e folmja e Moravës së Epërme.

**B a s h k ë t i n g ë l l o r e t s, z.** — Në fillim të fjalës ruhen besnikërisht si: *sörr-a, sy-ni, sít-a, zâ-ni, zemër-a, zi, i zi*. Ndërsa në mes të fjalës shpesh herë shkëmbehen me *c, x* për shembëll shqiptohen: *amëlcina, vjetërcina, egërcina* (nga ambëlsina, vjetërsina, egërsina), *gxim, u gxü, kallxü, me rrxü*, etj. Ndërsa në fund të fjalës *s*-ja kur është si sufiks që shërben për të formuar emra që shprehin profesionin shpesh herë kalon në *c* për shembëll: *ngrehc-i* (mjet te veku, avlëmenti), *shtjellci, rrenc-i, lypc-an, kelpc-i, kelpcîn, hupca (me dhân hupca për martës, i shkoj hupca), nerskamca, shtypc-i (shtypc i madh, dorështrënguat, koprrac), kraca* (krrabat e kerrit t'mramë). Kjo *c* është përfutur nga një *s* sufiksale nga: *ngrehë+s, shtypë+s, rrenë+s, lypë+s, kelbë+s, humb+hupë+s, ndër kambë=nerkambë=s, shtypë+s, krahë+s*, e shumë fjalë të këtij grupi kanë ndjekur të njëjtën rrugë si mbiemrat: *i ulcavt (nga ujë+s, ujsavt, ulcavt)*. *S*-ja ka kaluar në *c* te fjala *cic (sisë)*, pastaj te emrat e shkurtuar të personave si *Can (Hasan), Cuf (Jusuf)*.

Në disa rase *s*-ja kalon në *z* si: *autobuzi, krahazim, amëlzim, xhelbzim, interesi, Kukzi, nerzgojza, fytaz, zhagaz, fytza* (nga: *autobusi, krahazim, ambëlsim, gjelbësim, ndër gojësa, fytas, zhagas*, e kështu me radhë). Si tingull korelativ i spirantit të zëshëm *z*, tingulli *s* kur gjendet para labialeve *b, v* dhe dentalit *d* në funksion të ndajfoljes së mohimit rregullisht kalon në *z* si për shembëll: *z'bôn, z'bin, z'vjen, z'dal, z'di, z'dü* etj. Si shihet këtu kemi të bëjmë me karakterin fiziologjik, ku organet e të folurit adaptohen sipas sonoritetit të tingujve.

Te shumësi i emrit *garpër* na paraqitet një *s* epentetike si: *xharpën, xharpsi, xharpsit* (shiko toponimet *Te Lluga e xharpsive* në fshatin Kmetovc, *Te gurt e xharpsive* — Rogoçicë).

*Z*-ja diku kalon në *x* si: (*rrunëz-ak*) *rrunxak, gxim, xekërr-i, m'u xekërrü* etj.

**B a s h k ë t i n g ë l l o r e t sh, zh.** — Shqiptohen besnikërisht në të gjitha pozicionet e fjalës. Në raste asimilimi këta dy tinguj shkëmbehen ndër-mjet veti. Këta dy tinguj shqiptohen besnikërisht edhe në togjet konsonantike: *shk, shp, shl, shkr, zhb, zhg*. Në mënyrë shumë të prerë ngritet treva e

krahinës së Gollakut ku këta dy tinguj *sh, zh* para tingujve: *k, p, b, f, l* nuk ruhen, por kalojnë në *ç* e *xh*. Në të folmen e Moravës së Poshtme ruhen këto grupe konsonantesh: *shk, shp, shf, shkr, shpr, shl, shpl, zhb*. Të sjellim disa shembëlla sa për konkretizim: *me shkÿ, me shkōç, me shkāp, me shkēp, me shfrÿ, me shkrÿ, me shkri, me shkrēp, me shprish, shlÿj, shlir, me shlirÿ, me shplÿ, me zhbā, me zhbirÿ, zhgÿn*, ndërsa në Gollak, Llap e treva të tjera të Krahinës së Kosovës ndeshim trajta me *ç*: *me çkÿ, çkōç, me çkāp, me çkēp, me çkri, me çprish, me çfrÿ*, etj. Një *ç* nga njëherë kalon në *sh* për shembëll nga *ç'farē = çfar = shfār* e pastaj edhe *zhdār, zhdār* kali *kish ble veç* me *pā kuç = kuçlina = kushlina* (Përlepnicë). Ndërsa te fjala *zhapini zh*-ja është shurdhuar në *sh*: *shapini*. (*I kish syt e verdh si shapin*).

**Bashkëtingëlloret *c, t, d, n*.** — Nuk janë larguar nga sistemi i përgjithshëm konsonantik i mbarë shqipes dhe si të këtilla ruhen besnikërisht në çdo pozicion të fjalës, përpos *c*-së e cila nganjëherë mund të jetë një shkrireje e *ts*-së, siç *tsh* në *ç*. Për shembëll: *bucina, tuc-i, (butësina, tutës)*. Një *c* siç e theksuam më lart mund të jetë refleksi i *s*-së si: *verdhcina, egërcina, amëlcina, milic*, etj. Ndërsa *n*-ja fundore te mbiemrat foljorë kalon në *m*, shqipfolësit e kësaj treve gjuhësore kështu i shqiptojnë mbiemrat foljorë që pasojnë: *i ārdhum, i pāsum, i dāshum, i vēshum, i dēshum*, krahas trajtave: *i ārdhum, i pāsun, i dāshun, i vēshun, i dēshun*, në të folmen e Moravës së Epërme. Kurse *t*-ja e *d*-ja varësisht nga pozitat në fjalë shpesh, nën ndikimin e bashkëtingëlloreve përkatëse, të zëshme apo të shurdhëta, shkëmbehen njëra me tjetrën. Ndërsa *t*-ja fundore në shumicën e foljeve nuk alternohet me *s* p.sh. *zbut = zbuti, lūt = luti, vādīt = vaditi, gōdīt = goditi* duke marrë një *i*, e shumë rrallë ndëgjojmë trajtat *zbus, lus*, etj.

**T**-ja shurdhuere fundore rëndomë bie te shumësi i emërave kur shërben si mbaresë rasore për të treguar shquesinë e emrit qoftë në gjinië mashkullore, qoftë në ate femërore, në gjenetiv, dativ dhe ablativ si: *leshi i dhenve (dhenëvet) tona ā ma i būt. Shko n'ōd t'burrave (burravet). Ky viç āsht i lopve (lopëvet) tona*. Këtë dukuri e ndeshim shpesh edhe në vepra të ndryshme letrare. Kjo *t* fundore bie edhe në vetën e dytë shumësi të imperfektit si: *ju shkojshi, thojshi, ju prashitshi*, në vend të *shkojshit, prashitshit*. Në këtë të folme *t* ka rënë edhe në fjalët: *i nērmjem, i sivjem, i vjem, i parvjem* në vend të: *i ndērmjetmē, i sivjetmē, i vjetm, i parvjetm*.

**D**-ja fundore tek fjalët (që shërbejnë si emra) me origjinë orientale, desonorizohen në *t* si: *Rushit, Hamit, Halit, Mehmet, Bexhet (Rushid, Hamid, Halid, Mehmed, Bexhed* etj.). Gjithashtu *d* është desonorizuar edhe në grupin *nd* te fjala *i smūt (smuja), i sēmundē* (tosk. *i sēmurē*). Në këtë fjalë më parë është reduktuar grupi *nd* në *d* e pastaj *d*-ja është desonorizuar në *t*.

**L**abiodentale *f*, v. — *F*-ja ruhet në çdo pozicion të fjalës, në pozicion nistor, në mes dhe në fund. Si cekëm edhe më lart *f*-ja mund të jetë reflektuar nga *th*-ja si: *fëll, i fëll, (nga thellë, i thellë), ufëll*, ndërsa nga njëherë kthehet në *th*: *thmi*. Në raste të tjera ruhet besnikërisht: *femën, fletē, flutēr, oshaf, pilaf, plaf*. *F*-ja para *sh*-ës kur formojnë një grup konsonantik *fsh* bie, për shembëll: *kashore, me kashū, mnash, t' pasha me t' mira* (por edhe *t'pafsha*), kurse ruhet në fjalët *kofshē-a, lafshē -a*. *V*-ja në të shumtën e rasteve ruhet në të gjitha pozicionet e fjalës, por shpesh në pozicionin nistor, kur gjendet

para: *sh, ll, d, n*, bie, për shembëll: *është shtir me mrii açe, po del lavra shtir, Llashticë, Lladovë* (nga *vshtirë, Vllashtica, Vlladovo*, fshatra në komunën e Gjilanit), me *dëk*, te Bogdani kemi trajtën metatetike me *dvëk*. Në Përlepnicë e Dajkovc ndëgjohej trajta *me ndu, e ndova, e ndove* (nga *vend, me vendù, vendeje*, përballë trajtës *me vnu, vnoje*, në fshatrat të tjera të kësaj treve dhe në të folmen e Moravës së Ekërme). Te një numër fjalësh *v-ja* e zhdukur mund të konsiderohet si prefiks, por ajo është mjaft e shpeshtë edhe si sufiks: *me u keçäv, me u shtihäv, me u saritäv, me u pluhnäv, me u shkokërdhäv, ndylläv, lloçkäv, shterbäv, zhongläv, buhäv*, në vend të: *me u keque, me u shtihue, me u shti, me u zverdh, me u pluhnü, me u saritü, shkokërdhue*, etj. Mendoj se kjo dukuri është ndikim i serbokroatishtes, *blatav-a, -o*, (i përloçun), *buhav-a -o* (i, e, të, butë).

*V-ja* si tingull epentetik paraqitet në më të dy zanoreve për të prishur hiatusin. Kjo dukuri është e rëndomtë në këtë të folme: *vllavi, shkavi, Vorret e shkive* (*Hogosht*), *rri para kive, kavi, thivi, shivi, dhevi* (*Te Thërra e thivit* — Muçivërc), *kuvalt* (*Udha e kuvalve*), *xhivi*. Te mbiemrat: *i rivi, i zivi* (khs. te arbëreshët e Italisë: *trim i rivo, hënë e revo*).<sup>28</sup> Këtë dukuri e ndeshim edhe në të folmen e Tetovës.<sup>29</sup> Një *v* epentetike e ndeshim edhe te foljet në aorist: *shkova, punova, i lava, e pava, i thave, i rave, blova, u rrova, piva, xhova*, por paralel me këto kemi edhe trajtat: *blujta, u rrujta, pita, pina, nxina, xhujta, u lajta, e pae, i rae, i thae* etj.

*V-ja* në disa emra toponimesh nën ndikimin e bashkëtingëlloreve të shurdhëta kalon në *f*, për shembëll: *Sllakofc, Muhofc, Kūfc*. Kurse në disa rasa kjo *v*, e cila gjendet para *c-së* pasi në mes tyre është zhdukur *a-ja* e paqëndrueshme sllave (khs. në shqipet *me vlu, me shplu*, nga *valë, me valu, palë, palu, me shpalu, me shplu*), nuk bie, por ruhet si: *Leskovc, Bujanovc, Tërrnovc*. Ky fenomen shpjegohet sepse këtu jetojnë bashkarisht dy kombe, ndërsa në trevën e Gollakut ku jetojnë vetëm pjesëtarët e kombësisë shqiptare dhe në tërë Sërbinë e Jugut kjo *v* para *c-së* fundore të fjalëve sllave ka rënë krejtësisht: *Bijanoc, Leskoc, Miratoc*.

Bilabiale *p, b, m*. — Këto bashkëtingëllore ruhen besnikërisht në të gjitha pozicionet e fjalës. *P-ja* dhe *b-ja* nuk kanë pësuar ndërrime të mëdha. *B-ja* në fjalët turke dhe arabe në fund të fjalës kalon në *p* si: *çitâp, xhevâp, Ejup, sebeb* (*çitâb, xhevâb, Ejub, sebeb*). Një numër të kufizuar të fjalët e huazuara orientale bilabiale *b* ka kaluar në labiodental *v* p.sh.: *abdes=avdes, tebdil=tevdil, Abdi=Avdi, Abdyl=Abdullah, Avdyl=Avdullah*. *P-ja* dhe *b-ja* gjithashtu këmbehen në raste të asimilimit; si: *i elpt, i belpt* (*i elbët, i belbët*). *M-ja* ruhet edhe në mbiemrat participorë në të dy gjinitë si: *i lâm, i thâm, e lâme, e thâme, i lavrûm, i punûm, i marûm, e gatûme, e lÿme, e thÿme, e përlÿme, e nxhÿme*. Ndërsa në të folmen e Moravës së Epërme ndeshemi me trajtat me *n* si: *i lân, e thâne, e lãvrûne, e punûne, e gatûne, e lÿne, e përlÿne, e nxhÿne*, etj. Duhet përmendur se *m-ja* altërnohet me *n*. Kështu kemi te mbiemrat foljorë: *i dâlum, i fâlum, i nâlum*, në vend të: *i dâlun, i fâlun, i nâlun*.

Togjet konsonantike *mb, nd, nt, mp, ng, ngj, fsh, fl, lk*. — Togjet konsonantike *mb*, e *nd* nuk ruhen besnikërisht në mbarë trevën e Mora-

<sup>28</sup> Eqrem Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, Studime filologjike 3, 1965, 3.

<sup>29</sup> Remzi Nesimi, *vep. e cit.*

vës së Poshtme. Togu *mb* nuk ruhet fare, ai është reduktuar në *m* si: *me mlëdh*, *me mët*, *mës*, *mās*, *mrëna*, *përmi*. Ndërsa togun *nd* në një pjesë të mirë të fshatrave të kësaj treve ruhet duke na dhënë një pasqyrë proporcionale të përdorimit të këtij togu bashkëtingëllor, për shembëll thuhet: *ndryshe*, *ven -i*, *me kuvën*, *menim*, *nān*, *mrena*, *knena* (Moravica *andena*, *knena*) por ndëgjohen edhe format: *vend-i*, *me kuvënd*, *si mas vendit bahet kuvendi*, *mendim*, *nānd*, *i rānd*, *mrenda*, ndërsa thuhet *me dā*, *un dāj*, *u dān*, *dryshk*, *nāsht*, në vend të: *me ndā*, *un ndāj*, *u ndān*, *ndryshk*, *ndāsht* (nga *në* + *dash*). Mirëpo, në këto shembëlla *n* -ja nuk mund të konsiderohet si grup konsonantik por si prefiks që i është ndajstuar numrorit *dy*, *me da*, *mē nda*, pastaj, siç kemi edhe në fjalën *bukëndore*, *bukënore* që sipas Çabejt janë rrjedhoja të emrit *dorë*,<sup>30</sup> sikurse kemi fjalën nga *da* + *në* + *dyshe* + *dandyshe*, ku ka hyrë më vonë *ll*-ja dhe sot kemi *dallëndyshe*. Kështu edhe *mb*-ja nuk është grup konsonantik në fjalën *bukë mbrume* = *būkmrume*, sepse fjala bazë është emri *brum-i*, ndërsa *m*-ja është si prefiks duke krijuar foljen *me mbrumue*.<sup>31</sup>

T o g u *nt*. — Ruhet besnikërisht në të gjitha pozicionet e fjalës; thuhet: *ment*, *çent*, *dhent*, (khs. në të folmen e Sh. Bajgorës: *mët*, *çët*, *dhët*).<sup>32</sup>

Togu konsonantik *mp* edhe pse ka fytyrën e togut bashkëtingëllor ky gjithënjë është i prejardhur nga një *m* prefiksale + fjala që *pason emër* + *folje*, apo ndonjë pjesë tjetër e ligjeratës, andaj si i këtille ky nuk ruhet: *me u pi*, *me u plāk*, *me u pāk*, *i preht* (*Guri i prëht* — Përlepnicë), në vend të trajtave: *me u mpī*, *me u mplāk*, *me mpōsht*, *i mpreht* etj.

T o g u *ng*. — Nuk ruhet në çdo pozicion të fjalës, ndërsa atje ku nuk pandehet si prefiks ruhet me besnikëri të përpiktë. Për shembëll: *kājik*, *kāikatār* (e rralë herë kongatār), *për guti*, *pi kahit*, në vend të: *kēngëtar*, *për ngut-i*, *prej nga*, etj. Ndërsa ruhet në fjalët: *me ngurrū*, *i ngurravt*, *ngit*, *ngāt*, *ngūsht*, *kungi*, *cung -i*, *shlūng*, *gūng*, *lūng*. Togu *ng* ruhet edhe në fjalët ky *n*-ja pandehet si prefiks, për shembëll: *me ngarkū*, *me ngatrrū* (*jan ngatrrū nermjet veti*), *me ngūjū* (*ngūjōre*), *me ngallū* (*ka ngallū gruni*), *ngallic* (*kept kan çit ngallica*). Fjalë këto të cilat, sipas E.Çabejt, *n*-ja konsiderohet si prefiks (khs. *me ngarkū*, *e shkalkoj*, *ngalkoj*, *zbres nga kalī*. *Me ngatrru*, nga *katër*, *shkatërr*, *shkatrrōj*, *me ngallū*, *ngallic* lidhen me *kalli -ni*, ku kemi një verb denominativ të *kallit* kompozuar me *n*, e cila solli asimilimin e *k*-së në *g*, me *ngūjū*, është një verb denominativ i kunjit.<sup>33</sup> Në këtë drejtim mund të shpjegohet togu *ng* edhe në fjalët: *me ngallmū*, *me ngurrū*, *me ngërmū*, *me ngūl* (*me shkūl*). Ndërsa fjalët *me ngēl* (*jam ngēl*) *ngelaç*, *ngalc*, të cilat Çabej i konsideron si fjalë të vjetra autoktone.<sup>34</sup>

T o g u *ngj* që në këtë të folme ndëgjohe me qiellëzore afrikate *nxi*; ruhet pothuaj besnikërisht në të gjitha pozicionet e fjalës, pos në disa të rralla

<sup>30</sup> Eqrem Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, Studime filologjike, 4, 1964, 91.

<sup>31</sup> Mehmet Halimi, *Aglutinacioni si dukuri gjuhësore dhe roli i tij fjalëformonjës*, Jehona, 4, 1970, 32.

<sup>32</sup> Dr. Latif Mulaku, *punim i cituar*, 53.

<sup>33</sup> Eqrem Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, Studime filologjike, 4, 1964, 101.

<sup>34</sup> Po ai, *po aty*.

në ndonjë fshat të veçuar të fisit kastrat, ku është ruajtur forma e të folmes amë. Ky tingull shkembehët me *nj*. Pra kemi: *kinxh, nxhits, me nxhäll, ja nxhiti*, por ndëgjohen edhe trajtat: *ja njiti, njeti, unju, njôm*, dëshmi më e sigurt e pranisë së *nj*-së në vend të *ngj* janë edhe toponimet *Ara e Anjelkit, Kroni i Anjelkit, në vend të Angjellkit*. Këtë dukuri e ndeshim në fshatin Hogosht tek pjesëtarët e fisit Kastrat, veçanërisht në brezin e vjetër, i cili ka ruajtur format e vjetra siç ruhen edhe sot në të folmen e Kastratit,<sup>35</sup> e në të folmen e Ulqinit e të Malësisë së Madhe.

**T o g u fsh.** — Të shumtën e rasave kalon në *sh*, për shembëll: *kashore, me kashü, kashöj*. Ndërsa në anën tjetër në një grup fjalësh ruhet: *köfsh, läfsh -a, me fshî, me fshâ* (në këto dy shembëllat e fundit është si prefiks). Në mënyrën dëshirore të foljeve me zanore, haset gjithnjë togu *fsh* e shumë rrallë ndodh që edhe të bjerë *f*-ja. Për shembëll: *shkofsh, kurr mos knofsh, u qafsh, u shkefsh, t'pafsha me t'mira*, por edhe *t'pasha, t'lasha permas, t'thasha mâ, ma mir ma bofsh!*

**T o g u fl.** — Ruhët besnikërisht e shumë rrallë shkembehët me togun *fj* *shutër, fluturoj, flët, flök, fläk*, por përveç trajtës *me flëjt, me flët* ndëgjohejt edhe trajta *me fjët*.

**T o g u lk:** *k, uk, ukî, pÿk* (nga *ulk-önj, pylk, pyjk*) ndërsa ajk (alk).

**T o g j e t kl, gl;** këto dy togje të vjetra konsonantike që i ndeshim në gjuhën e shkrimit që nga koha e Buzukut, si në mbarë gegërishten, po ashtu edhe në të folmen e Moravës së Poshtme kanë përfunduar procesin e evolimit të tyre në *k, g* shih fjalë: *me kôn, me kësh, kinxh, këp -a, kûsht* (nga *kulmesht = kumsht = kûsht*); glëndër:gjandër:gandër,<sup>36</sup> *gûh -a, gû -ni, me zgëdh, me zgîdh*. Ndërsa grupi *kt* është ruajtur: *lyktÿr -a*, ndërsa në ligjërimin e Hoshtevës kjo fjalë na paraqitet me *i liktÿr*<sup>37</sup> që heq burimin e saj nga latinishtja *ligatura* me kuptim *lidhje*, përkundër trajtës *lyftÿr -a* në të folmen e Moravës së Epërme.

**T o g u vn** — i sllavishtes si në mbarë shqipen po kështu edhe në këtë të folme ka kaluar në *mn* e në disa rasa ka arritur edhe në fazën e tretë *m*. Pra togu *vn*: *mn:m*. Paralel me trajtën *Ramnabûç -a, Ramnabâj -a*, ndëgjojmë trajtat në fazën e tretë *Ramabuç, Ramabâj -a, Ramidëj -a* (Gollak), *Ramnîsht* (Hogosht), *Gllamnik, Sllamnik, Gumnîsht -a*. Në këtë të folme *vn* slave ka dhënë edhe *n* si: *Babanik* (Hogosht), *Ranilluk*, nga *Babovnik, Ravnilluk*.

### Fenomenet fonetike

Në këtë të folme ndeshemi me fenomenet fonetike që janë cilësi e mbarë shqipes, duke u reflektuar në drejtime të ndryshme, andaj shembëllat që do të sjellim do të dëshmojnë për karakteristikat specifike të të folmes së kësaj treve gjuhësore.

<sup>35</sup> Gjovalin Shkurtaç, *E folmja e Kastratit*, Studime filologjike, 2, 1967, 43.

<sup>36</sup> E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1970, 134.

<sup>37</sup> E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, Studime filologjike, 2, 1964, 2.

**A asimilimi.** — Kjo dukuri fonetike shkaktohet nga konfrontimi fiziologjik i konsonanteve të zëshme: *b, gj, xh, x, z, zh, g, v, dh, rr, ll* dhe konsonanteve të shurdhëta: *p, q, ç, c, s, sh, k, f, th, r, l*, të cilat duke u gjetur njëra pranë tjetrës shkaktojnë vështirësi shqiptimi, andaj shqipfolësi i Moravës së Poshtme për arësye lehtësimiti në të folur i njëjtëson konsonantet fqinje për-kah natyra e shqiptimit. Nga kjo del se ndeshemi me asimilimin si dukuri fonetike shumë shpesh. Më i shpeshtë është asimilimi konsonantik regresiv. Vijimisht ndëgjojmë këto trajta të asimiluara: *i lakt, i dukt, i elpt, i xhelpt, i kelpt (Kroni i kelpt — Hogosht), i belbt, i dopt, i shurtht, pesthët, shtatthët, tetthët, serpli, me zbårdh, d'bårdh, z'dij, z'guxoj, zhdar, sllupc (nga serbishtja stubac:stubb:stupc:sllupc), Masçavza e Madhe (Dajkovc), mazdore, etj.* Në këtë hulli kanë hyrë edhe fjalët e huaja arabe e turke: *zëfk, Shefki, Shefkide, Muhamet, Mehmet, Sahit (nga zevk, Shevki, Shevqet, Shevkide, Muhamed, Mehmed, etj.*

**Metateza.** — Edhe kjo dukuri fonetike është bukur e përhapur në këtë trevë gjuhësore. Shqipfolësi në mënyrë të pavetëdijshme e shqipton fjalën metatetike ose për shkaqe lehtësimiti fiziologjik ose pse e ka trashëguar fjalën si të tillë nga prindërit e vet dhe rrethi ku jeton, në të cilën është e pranishme fjala përkatëse metatetike. Po sjellim disa shembëlla të fjalëve metatetike më të shpeshta: *tasjan* (frengj: station), *shpollak* (pshollak, pështjellak), *me kpüt* (me kpüt), *me shlü* (me lëshü), *hävëll* (hallvë), *jahat* (hajat), *me urtlü* (me rrotullu), *pallangoz* (pangalloz), *sllupc* (stupc, kamzë), *murrall* (mullar), *kopresh* (kërpesh, kapistër), *ushturhër* (shtruherë), *kundrushtar* (kundërshtar), *dyshimtar* (dëshmitar), *trubull* (turbull), *kërlän* (kryelanë), *hulät* (luhat), *zavit* (nga serb. voziti), *me shoklü* (nga me shkoklue, e kjo nga me shkokërrue, nga fjala bazë kokërr), *me pshü* (shpëtue).<sup>38</sup> Fjalë të metatizuara në këtë trevë gjuhësore ndeshim më tepër se sa në të folmen e Moravës së Epërme.

**Aglutinacioni.** — Ky fenomen fonetik në këtë të folme është i pranishëm si në të folurit e përditshëm poashtu edhe në toponime e që mbesin tipar veçues për këtë trevë gjuhësore. Unë po sjell disa shembëlla aglutinacioni duke qenë i vetëdijshëm se kjo gurrë gjuhësore nuk shterohet me kaq, pasi këtë dukuri fonetike duhet gjurmuar me pasion e durim në lëmën e gjuhësisë. Fjalë të aglutinuara pandehen: *midis* (nga *mjetvis: mjedis:midis*) përdoret shprehja *i kish ra për midis disit*. Pastaj fjala *tymen* tjerri që përdoret në avlëment, i cili mbulohet me ind (nga fjalë *të+hymën:thymën:tymën*). *Tamël* (*të+ambël*) *sahora* (*sa+asht+ora:saora*, ku *h*-ja ka hyrë si tingull epentetik), *bük nöre* (*bukë+në+dorë*), *bükmazdore* (*bukë mbas dore*), *shtruhër* (nga shtrue+erë), *mozomokeç*.<sup>39</sup> Po kështu mund të konsiderohen si aglutinime fjalët: *çashtu* (nga *qe+kështu*), *çaj* (*qe+ai*), *çajo* (*qe+ajo*), *çato* (*qe+ato*), *çanej* (*qe+andej*), *pale ta shohim* nga *pa+lee, etj.* fjala *laür*, në kuptimin *trinë* e cila lihet pasi të thurret ara ose kopshti për të kaluar njerëzit, është aglutinim i fjalëve *La+urë* ose *la-udhë*. Ndërsa në fshatin Shipashnicë e Epërme kemi

<sup>38</sup> Mehmet Halimi, *Metateza si dukuri fonetike dhe roli i saj gjuhësor*, Jehona, 10, 1970, 31.

<sup>39</sup> Mehmet Halimi, *Aglutinacioni si dukuri gjuhësore dhe roli i tij fjalëformonjës*, 30-35.

toponimin *Arasula* (nga ara e Sulës) e cila nga njëherë ndëgjohej edhe *Rasula*, ndërsa në Moravën e Epërme në Pozharan kemi *Resula:rosula:Rosuja* që nuk ka të bëjë me fjalën e aglutinuar që përmendëm. Në fshatin Rogoçicë kemi aglutininim që i përngjet kompozitës, *Kodra e Gojfilit* që i përngjet gojë së filit (elefantit) si *Kungullar-i* (Përlepnicë) që ka formën e kungullit. Në fshatin Koretin toponimi *Lejhtit*, e që populli e shpjegon nga *leni + thitë*, duke kaluar nga krishtenizmi në islamizëm. Për xhepa përdoret fjala *shkeka* e që mendoj se vjen nga fjala *shtjeka* të cilën Androkli Kostallari e nxjerr nga folja me *shtie + ka*, (khs. *shtiz*, nga *shtie*),<sup>40</sup> e ku pastaj *t -ja* ka kaluar në *k* si te fjalët me *shtÿm* dhe me *shkÿm*, me *shÿm*. Në të mirë të këtij supozimi flasim edhe frazeologjitë *ish ba shkëk*, e *bane shkëk* në kuptim ishte bërë tollovi, ishte bërë ngusht si në xhep. Në fshatin Përlepnicë ekziston toponimi *Te lugi i Trapadinave* e që është përfitim i fjalëve *Te lugi i Trapa + podinave* (khs. me emrin *Tankosić*, nga *tanko + kosić* ku është zhdukur *haplologjia* duke rënë njëra prej dy rrokjeve të ngjashme që përsëriteshin). Si aglutinime mund të konsiderohen edhe fjalët e dalura nga ablativi, si: *msysh* (nga *më + sy + sh*), *ka marrë xhali msysh*, e *kam thmîn për xhish* (*për + gji + sh*), *m'erdh ndôresh*, *nkamesh*, *kena* (nga *kemi + na*) *jena* (*jemi + na*). Një *n* të ndajshuar e ndeshim te të gjitha foljet e imperfektit sigmatik të vetes së parë si: *punojshna*, *knojshna*, *thojshna*, *shkojshna*, siç e ndeshim edhe tek përemrat dëftorë: *ktina*, *atina*, *ksajna*, *asajna*, të përemrat pronorë *i ktina*, *i atina*, *i ksajna*, *i asajna*, në vend të: *këtij*, *atij*, *kësaj*, *asaj*, *i këtij*, *i atij*, *i kësaj*, *i asaj*. Fjala *peja* me kuptim *afrohu* është aglutininim i fjalëve *po + eja*, ndërsa në Gollak përdoret *paja*. Fjala *hanedan* është aglutininim i fjalëve *han + e + dan*, një gjë që shihet sheshazi. Mendoj se do të ishte shumë me rëndësi të studjohet toponomastika e këtij regjioni gjeografik për të nxjerrë rrënjën burimore e semantike të shumë toponimeve.

**A f e r e z a .** — Ndëgjohej trajtat: *erfundî* (për fundi) e diku *erfujti*, *Zmerniki* (*Izmorniku*), *taljānk* (italjankë), *Rasūla* (ara e Sulës) si dhe të emrat e njerëzve shpesh bie zanorja e parë si: *Brahim* (Ibrahim), *Mēt* (Ahmet ose Mehmet), *Dēm* (Adem), *Māl* (Ismajl) *mik* (lat. *amicus*), *ngusht* (*angustus*) etj.

**S i n k o p a .** — *shpî* (*shtëpi*), *shmāng* (*shtëmangë*), *kejt* (*krejt*) — ablativi i kresë ku ka *r -ja*, *qetahi*, *tashi* (*qetashti*, *tashti*), ndërsa në rrethinat e Preshevës ndëgjohej trajta *shti*.

**A p o k o p a .** — *përzo* (për zotin), *kish* (*kishte*), *ish* (*ishte*), *mo* (*mos*), *mo zó ma keç* (*mos zot ma keq*), *mo zot allah* (*mos zot allah*), *pi smiri* (prej së miri), *nimé* (njëmend). Apokopën e ndeshim te disa emra personash si: *Bëjt* (Bejtullah), *Fëjz* (Fejzullah), *Hājir* (Hajrullah). Në këtë të folme apokopa nuk është e përhapur aq sa në të folmet e tjera si *p.sh* në të folmen e Kastratit ku në fjalët që mbarojnë me grupet *tn*, *tm*, *ln*, zhduket njëra prej bashkëtingëlloreve nga tempoja e shpejtë e shqiptimit.<sup>41</sup>

**E l i z i o n i .** — Elidimi i zanoreve në ketë të folme është mjaft i shpeshtë. Ai paraqitet më tepër në rasiat e elidimit të *e -së* të pjesëzës *me* të infini-

<sup>40</sup> Aleksandër Xhuvani — Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*. Tiranë, 1962, 108.

<sup>41</sup> Gjovalin Shkurtaj, *vep. e cit.* 45

<sup>42</sup> Eqrem Çabej, *Hyrye në Historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1970. 131.

titiv kur gjendet para pjesëzës *u* te foljet e diatezës pësore — vetvetore, ose para trajtës *u* të numrit shumës si: *pun' e madhe, xhali Hysenit, kali Tafes, Livadhi Haxhijes, m'u kërstit (me u kërstit, me bâ kryq), m'u habit (me u habit), pe lyp (po e lyp), pi thot (po i thotë), erdh vakti m'u nis (me u nis), duhet m'i thân (duhet me i thanë), duhet mu çû (duhet me u çû), hajde mu ba gati (me u ba gati), duhet mu lâ (duhet me u la), e të tjera shembëlla shumë të shpeshta.*

**Trajta të rotacizuara.** Siç ka vënë në pah Eqrem Çabej „rotacizmi nuk është një dukuri vetëm e toskërishtes, por merr pjesë në të edhe gegërishtja në disa rasa”,<sup>42</sup> *vner-i* prej trajtës *venenim* të latinishtës, *kunorë* (nga lat. *corona*), pastaj edhe fjala *urë*, në disa rasa ndëgjohet edhe trajta *mushkri*. Forma të rotacizuara në këtë trevë gjuhësore janë shumë sporadike.

**K r a s i s i.** — Në shqipet me kohë ka ndodhur një krasidomos kur kemi *ë + e* që dhanë *a*. Kjo duket qartë edhe tek përemrat e shkurtuar vetorë: *të + e = ta, më + e = ma*. Prandaj ndëgjojmë trajtat: *ma dha, ta tha* që shqiptohen bashkë, ndërsa në Llap e Drenicë ndeshim format *m'e tha, t'e dha*.

**Shtesa e tingujve** është bukur e shpeshtë, si: *jap (ap), nestra (nesër). Eshtrëf (Eshref), Rrafshina (Kopërnice)*, duke identifikuar me fjalët: *llomshtina, coftina*. Në fshatin Rogoçicë ndeshim toponimin *Fushtarllak*, ku emrit shqip *fushë* i janë ndajshuar sufikse të dyfishuara, një shqip *-ar* dhe një turqisht *-llak* (-llëk), kurse *t*-ja është tingull i shtuar *fush + t + ar + llak = fushtarllak*. *Gropshtina (Përlepnicë), xharpsi (gjarpij), shpind -a (shpin -a), stërnisht (sërnisht-a), flličtan (flličan), strez (srez)*.

### Thjeshtimi i grupeve tri konsonantesh

Gjatë zhvillimit të brendshëm të shqipes grupet tri konsonantesh janë thjeshtuar për shkak lehtësimi në të shqiptuar, e veçanërisht kur është ndonjë likuid: *kā i lubart, lopë e lubarme (nga i lubardhmë, bardhë), pjepën i përdert (i përderdhët), shtjellc, shjellc, shllungë*, fjalë të cilën Majeri, Pederseni e Çabej e nxorën nga fjala *shtjell*, duke marrë sufiksin, dha *shtëllungë*, si *shmangë* nga *shtëmangë*.<sup>43</sup> Këtë dukuri karakteristike e vuri në spikamë albanologu i shquar Norbert Jokl, duke parë se thjeshtimi i grupeve tri konsonantesh është bërë më tepër kur në të ka ekzistuar një likuid. Në këtë drejtim u shpjeguan një varg fjalësh, si: *kāsht (nga kalli, kallshtë), vjēsht (vjel, vjelshtë), brēsht (bredh + shtë), bjēshk (bjērshk), shkoj (shtek, me shtekū, shtkoj)*, etj.

**Geminacioni.** — Në disa rasa te disa folje të parregullta në aorist dhe imperfekt kemi dyfishimin e disa bashkëtingëlloreve: në vend të *po bijka shi* ose *po binte shi* thuhet: *po rākka shi, rākke shi, e pākke punën, e lākke punën, u pākke (u pakte, nga të fiktit), e fikke shpijen (e fikte shtëpinë), ikke (ikte), pikke (pikte), e shihkke (e shihte), e likke (e linte)*, Geminacionin e ndeshim edhe në fjalët: *dit e nat, u gjett, i trett, i dhētti, për s'trett, hër*. Disa folje që mbarojnë me *t* si: *me shīt, me brīt, me māt, me prīt, me fjēt, me mbēshtëtē*

<sup>43</sup> Eqrem Çabej, *po aty*.

për t'i ikur geminacionit në imperfekt marrin një *k*; për shembëll, në vend të trajtave: *shitte, britte, matte, pritte, fjette, u mbështette*, bëjnë: *shitke, britke, matke, flejke, u pshtetke*.

Ndërsa geminacioni ekspresiv, të cilin Eqrem Çabej e shpjegoi si një fenomen afektiv, është mjaft i zhvilluar si: *burrë, derr, rrej, rrotë, turr, rryp (e bani rryp, nga rjepë), rrem* (lat. *ramus*), por gjithnjë shqiptohet *zjarm, zjerm* e kurrnjëherë nuk ndëgjohej *zjarr*. Thuhet *kurfâl mos t'kofsha*, në vend të *kurr + falë*, sepse shprehet afekti.

## MORFOLOGJI

Emri si kategori gramatikore nuk largohet shumë nga sistemi i përgjithshëm i mbarë të folmeve geqe.

**G j i n i a.** — Kjo e folme ka tri gjini të emrit: mashkulloren, femëroren dhe gjininë asnjane. Gjinia asnjane në këtë të folme është në zhdukje e sipër; asnjane sit më së shumti po marrin gjininë mashkullore e rrallë edhe gjininë femërore. Thuhet: *mish-i, tlyn-i, voj-i, drith-i, uj-i*, por *mjält-a*. Gjinia asnjane ruhet ende në brezin e vjetër, *ky bunar e ka ujt e mir, e kapërcej ujt e dul n'at an, at-her krisën pushkt pi gximit*. Te brezi i ri, nën ndikimin e gjuhës letrare, gjininë asnjane e ndeshim shumë rrallë, ndërsa në Gollak gjinia asnjane ruhet ende, po-ashtu edhe ndër muhaxherë të ardhur nga rrethet e Leskovcit, Vranjës dhe Toplicës. Një grup emrash na paraqiten me dy fytyrë, janë emra ambigjenë, kështu që herë na dalin si emra të gjinisë femërore herë si emra të gjinisë mashkullore. *Faleminerit pi tye*, por edhe *Falemineres pi ty, piskatke n'kup t'çilles, Hyp n'lis e kçyr çillit përpjët*, thuhet *libër-a*, e kurr s'thuhet *libri*. Në disa fshatra si Përlepnice, emrat e personave të botës femërore, mashkullorizohen: *Remzije, Ilmije, Nafije, Hamdije, Hajrije, Lutfije, Naxhije, Ismete, Igballe, Rafete, Safete, Vahide*, e të tjerë, shqiptohen si emra të gjinisë mashkullore *Remzi, Ilmi, Nafi Hamdi, Rafet, Safet, Vahid, Igball*, e kështu me radhë. Ndërsa emrat e gjinisë mashkullore natyrore të disa personave na paraqiten në gjininë femërore gramatikore, si: *Xhëm, Râm, Kël, Mët, Sjl*, e të tjera.

**Shquesia.** — Emrat e gjinisë mashkullore që mbarojnë me grykoret *k, g, h*, kur të shquhen marrin mbaresën *i mik-i, brisk-i, plak-i, konak-i, zog-i, lug-i, pllug-i, ah-i, krah-i*. Ndërsa janë një grup emrash që nuk e kanë trajtën e pashquar, por vetëm të shquarën, si: *shati, guri, kali, kall, deti, ja dha ni shati, zateti me ni guri e u rrxu, shkoj me kali, Sivjet u ba kallamoçi deti*, e kurr nuk thuhet: *i ra me shat, zateti me ni gur, e u rrxu, Sivjet u ba kallamoçi det*. Në anë tjetër kemi një emër që nuk posedon fare trajtën e shquar, por vetëm të pashquarën thuhet: *Sa är asht ky oborr, e kom ble ni är 27 är*, përballë trajtës së Moravës së Epërme ku mungon trajta e pashquar, pra kurrë nuk thuhet *ar*, por *ari*. *Sa ari asht ky oborr, e kam ble ni är 27 ari*.

Emrat mashkullorë të cilët në trajtën e pashquar mbarojnë me zanore të gjata *ā, ē, i* në trajtën e shquar sosin me *i* duke u futur edhe një v epentetike: *vllā -v -i, kā -v -i, dhē -v -i, shī -v -i, thī -v -i*, etj.

Te emrat të cilët në trajtën e pashquar mbarojnë me *-ull* e *ur*, e që në këtë të folme kanë kaluar në *-ëll*, *-ër*, kur të shquhen kjo rrokje bie. Në vend të: *akull*, *vetull*, *petull*, *sjetull*, *kungull*, *kungur*, *lepur*, *hekur*, *flutër* thuhet: *akëll*, *vetëll*, *petëll*, *sjetëll*, *kungi*, *lepër*, *hekër*, *flutër*. Këta emra kur të shquhen marrin këtë fizionomi: *aklli* (*Te kroni i akllit*), *petilla*, *sjetilla*, *vetlla* (*bukën nersjetilla kapuçin përmi vetlla*, top. Te *Vetlla*), *lepri*, *hekri*, *flutra*. Ndërsa emri *kungull* më tepër përdoret në trajtën *kungi* si në njëjës si në shumës. Emrat e gjinisë mashkullore si: *Ali*, *Nazmî*, *Hamdî* e të tjerë kur të shquhen marrin mbaresën a dhe një j eufonike: *Alija*, *Hamdija*, *Nazmija*, etj.

**Shumësi e emrit.** — Nëpër fshatrat e shpërndara të kësaj treve gjuhësore na del si një mozaik me shumësi formash. Disa emra e bëjnë shumësin duke marrë nga një *e ven(de)-e*, por edhe *vena-vena*, *katun-e*, *mal-e*. Duke marrë një *a doktor-a*, *profesor-a*, *inxhiler-a*, *msus-a*, *nxans-a*, por edhe *nxansi*. Duke zbutur *k* -në në ç: *plak*=*pleç*, nga njëherë duke marrë edhe një *e pas ç*: *lak*=*laçe*, *leçe*, *hak*=*haçe*, *xhak*=*xhaçe*, *konak*=*konaçe*, *oxhak*=*oxhaçe*. Pa kaluar *k* -ja në *q*: *bardak*=*bardāk*, *oxhak*=*oxhāk*, ndërsa *gardh-çe*.

Duke palatalizuar e kthyer në afrikate *g* -në në *xh*: *pllug*=*plluxh*, *lug*=*luxhe*, *breg*=*brexhe*, por *zog*=*zøj* (si *zajt* e *pulës*), *burg*, *burxhe*. Duke marrë një *na*: *ball-ballna*, *shatî-shetna*, por edhe *shetnej*, *shatnoj* (në Gollak *shyti*=*shytna*). Këtu *saç*=*seçna*, *i thati*=*i thatna*. Emrat që, në njëjës mbarojnë me *ën* në shumës marrin *oj*: *drapën*=*drapnoj*, *drapnej*, *drapna*, *xharpën*=*xharpnoj*, *xharpnej* e më shpesh *xharpshi*. Trajta e fundit është manifestuar edhe në toponime. Njësoj me njëjës, por duke e shkurtuar *ō* -në: *lōp*=*lōp*, *flōkt*. Një numër i mirë emrash i shtrohen metafonizmit: *dash*=*desh*, *sjap*=*sjep*, *thes*=*thas*, *rrath*=*rrath*. Duke marrë prapashtesën turke =*llar*: *äg-agallār*, *bāb*=*baballār*, *hōxh*=*hoxhallār*, pastaj edhe me prapashtesë =*lēr*=*haxhi* — *lēr*, *dervish*=*lēr*, *beg-lēr*, *sheh-lēr*. Me anë të supletivizmit si: *njēri*=*xhin*, *delme*=*dhēn*, *ka*=*kije*, e të tjerë.

**Rasat e emrit.** — Pos gjashtë rasave shumë shpesh përdoret edhe rasa e shtatë—*vendorja*. Emri në ablativ përdoret kur tregon cilësinë e emrit të parë, kur dy emra japin një kuptim të caktuar: *kam hangër mish lope*, e *bani lesh lope*, *mish kinxhi*, *mish pule* (*e hangra ni kaçik pule*), *i vogël sa ni zog pule*. Këto trajta i hasim vetëm në trajtën e pashquar, ndërsa në trajtën e shquar thuhet: *mish t'lopës*, *blejta mish t'kinxhit*, *sa ni zog i pulës*, e jo si e folmja e Shkodrës dhe Malësisë së Madhe *mish kingjit*, *zog pulet*, etj. Ablativi me mbaresën *-sh* është mjaft i rrallë thuhet: *pi pemve*, *pi grave*, *pi burrave*, *pestil pi mollave*. Ablativi me mbaresën *-sh* përdoret më tepër në frazologji dhe grupe fjalësh: *llaf grash*, *pun burrash*, *lōj thmish* (*axhamish*), *përXHish*, e *kapën përsysh*, *i ra t'msysh*, *i shkon doresh*, *i erdh doresh*, *i erdh nkamesh*, *i erdh hakësh*, e të tjerë shembuj që paraqesin grupe fjalësh të pandara. Rasa vendore përdoret mjaft spikatur: *i ra n'çāf*, *i hypi n'çāf*, *e mūr n'çāf*, *n'çāf e bājti*, *i hypi n'krÿ*, *hyp n'maje t'lisit*.

## Mbiemri

Gjinia. — Edhe mbiemri si një ndër kategoritë gramatikore posedon tri gjinitë ashtu si edhe emri. Gjinitë e tij tek mbiemrat e nyjshëm dallohen në bazë të nyjës që kanë përpara: për gjininë mashkullore *i*, për femëroren *e*, ndërsa për gjininë asnjënjësore *të*; *i mir*, *i zi*, *i trësh*, *i holl*, *i bardh*, *e mir*, *e zez*, *e trësh*, *e holl*, *e bardh*, *t'zit e thonit*, *t'trasht*, *t'bardht e synit*, *t'keçt e shpyrtit*, e të tjerë. Ndërsa te mbiemrat e panyjshëm gjinitë dallohen sipas mbaresës së shquesisë njësoj sikurse te emrat.

*Shumësi* — mbiemrat e nyjshëm e bëjnë duke ndryshuar nyjën e përparme *i*, *e* në *të* dhe *së*. Lakohen nëpër rasë njësoj sikur emrat kur janë vetëm, ndërsa kur gjenden bashkë me emrin, mbiemri nuk lakohet. Në këtë të folme mbiemrat gjithnjë vijnë pas emrit, por në raste të rralla, atëherë kur shqipfolësi i kësaj ane do të theksojë një gjë më dallueshëm ose do të shprehë habi për një gjë apo do ta potencojë qëllimisht cilësinë e një frymori ose objekti duke dalluar prej të tjerëve, në këtë rasë mbiemri del përpara emrit: *Po t'mirin xhâl ç'i ja kish fâl i lumi Zot!* *Po t'miren nuse ç'i e kish marr!* *Nafakbardha t'mirin burr ç'i e kish!* *E mira ç'ik ç'i ish bâ!* Mbiemri shpesh herë substantivohet: *i miri*, *i keçi*, *i miri me t'miren i keçi me t'keçen*, *e mira e ka t'miren*, *moj e mira n'çato male*. Mbiemrat e përngjitur janë të formuar prej dy emrash ku emri i dytë shërben si cilësor për të parin: *kryeshinik*, *kryekungull*, *ballashyt*, *syçelik*, *kryekali*, *grykfyt*, *sylesh*, *çaflesh*. Mbiemra të këtillë janë shumë të përhapur.

*Emër + mbiemër*: *çafgât*, *syzi* (*syzët*), *vetulltrësh*, *shtatshkûrt*, *kryefört*, *zemërbût*, *shnetlig*, *shpÿrtlig*, *shpÿrtngÿsht*, *zemërguri*, *zemërgjân*, *zemërngÿsht*.

*Emër + folje*: *gojhapt*, *syhapt*, *zemërprisht*. Në këtë të folme mbiemrat foljorë sosin me *m* fundore në vend se me *n* dhe theksi i shkurtër bie në rrokjen e parë. Këtu po rradhimisht përballë shembëllave nga Morava e Poshtme edhe trajtat nga Morava e Epërme:

E fol. e Moravës së Poshtme

*i p̄sum*  
*i d̄ashum*  
*i d̄alum*(menç)  
*i f̄alum*  
*i n̄alum*  
*i t̄erum*  
*i ărdhum*  
*i kn̄açum*

E fol. e Moravës së Epërme

*i p̄sum*  
*i d̄ashum*  
*i d̄alum*(menç)  
*i f̄alun*  
*i n̄alun*  
*i t̄erun*  
*i ărdhun*  
*i kn̄açun* e kështu me radhë.

Këtë dukuri e ndeshim edhe në të folmen e rrethinës së Tetovës si: *i djegëm*, *i dalëm*, *i ardhëm*.<sup>44</sup> Një tipar specifik për këtë të folme janë edhe mbiemrat participorë. Ndërsa në të folmen e Moravës së Poshtme kanë trajtën e drejtë në atë të Epërmen i ndeshim me trajtën e prishur.

<sup>44</sup> Remzi Nesimi, *Fonetike karakteristike albanskog govora Tetovske okoline*, 1971, 57 (dorëshkrim).

## Morava e Poshtme

*pulë e pjëkme*  
*e shitme*  
*e prëme*  
*e punūme*  
*t'pām*  
*e thÿme*  
*e lāme, e dāme e çāme*

*e krehme, e rrehme*  
*Udhes t'rrehme e grūs*  
*t'krehme kurr mos ju daj*

## Morava e Epërme

*pulë e pjëkne*  
*e shitne*  
*e prëne*  
*e punūne*  
*t'pān*  
*e thÿne*  
*e lāne, e dāne, e çāne, e lshūne, e*  
*gatūne*

*e krehne, e rrehne*  
 = *Udhes t'rrehme e grus t'krehne kurr*  
*mos ju daj.*<sup>45</sup>

Njësoj ndodh edhe me mbiemrat participorë të gjinisë mashkullore: *i lām (i lān), i dām (i dān)*. Edhe mbiemrat kanë rasët e lakimit. Rasa rrjedhore mund të paraqitet shumëfarësh, si: *cilësor plotësor; si kundrinë, me mbiemra pjesorë dhe si plotësor*.

1. Si cilësor plotësor: *xhāl shkolle, mīsh kinxhi, çarāp leshi, çën zinxhiri*.
  2. Si kundrinë: *fjalë grash, punë burrash, lōj thmish*.  
 a. me folje: *lagna ftyres, çit dursh, i erdh n' doresh, i erdh n' kamesh*.  
 b. me mbiemra pjesorë: *i dālum menç, i shpërlām gojesh, i fshim n'bëth t'çibritit, i çorrūm n'dy sysh*.
  3. Si plotësor: a) *Vendi: m'u ēn udhve, me hēc fushēs, me dāl malit*.
- b) Si plotësor kohe: *vjeshtes, veres, dimnit*.

## Përemri

Përemri vetor është më karakteristik gjatë lakimit të tij. Përemri vetor në vetën e parë: *une, una*. Përemrat vetorë *unë* dhe *ti* gjatë lakimit të tyre bëjnë njësoj në rasën *gjindore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore*.

gjindore	dhanore	kallëzore	rrjedhore
mū të	mū ma	mū më	pi mū (e)
tÿ (e) të,,	tÿ (e) të	tÿ (e) të	pi tÿ (e)

Përemri vetëvetor *vet* shpesh herë gjendet para përemrave vetorë kur do të rrëfejë me gisht subjektin për të cilin është fjala, i cili flet ose kryen ndonjë punë: *vet une i kam fājet, vet una i thash, vet çë ky bir nāne i dola*

<sup>45</sup> Mehmet Halimi, *Fjalë të urta nga Morava e Epërme*, Jeta e re, 6, 1969, 1101.

*përpara. Vet na i tham çu z'ban çashtu, Vet ju na that se na s'kishum ardh kaç heret. Vet aj plaki ish çu e erdh drejt n'konak tön.*

Te përemrat pronorë mjaft dendur e gjejmë përemrin: *i vet, i veti, e vet, e vetja, e veta: xhali e vet, çika e vet, ara e vet, arat e veta*. Trajtat: *i veti, e vetja, t'vetat* përdoren pa emra.

Në gjinin mashkullore, për njëjës *i vet (xhali i vet)*, për shumës *e vet (xhemt e vet)*. Ndërsa për gjininë femërore në njëjës *e vet (çika e vet)*, për shumës *e veta (çikat e veta)*.

Nga *ky, kjo, asaj, kësaj* janë formuar përemrat dëftorët të cilët tregojnë më tepër llojin, farën e një gjë sendi apo frymori, si: *ksine, ksishna, asine, asishna, asajna, ksajna (asajna i dhash mill, e ksajna buk)*.

Përemri pyetës — për njerëz më tepër përdoret: *kush, cili, cilla, cillt, cillat*. Ndërsa për objekte e kafshë: *shfër, cilli, cilla, cillit, cillat*.

Përmemrat e pakufishëm më të shpesh të janë: *dikush, diku-shi, kërrkush-i, njëni-njona, asnjani, asnjana, kurrnjani, kurrnjana, askush-i, xhithkush-i, çdokush, secilli, secilla, xhithsecilli, xhithsecilla, dikon, kurrkon, xhithkun, xhithkon, e të tjera*.

### Numërorët

Numërorët rrjeshtorë kanë dy gjini: *mashkullore dhe femërore: i pari, e para, i dyti, e dyta, i treti, e treta*, e kështu me rradhë duke marrë nyjet e përparme si mbiemrat cilësorë.

Duhet theksuar se te numërorët rrjeshtorë me sy dhjetëshe e përpjetë vetëm dhjetëshja e fundit ka trajtën e numërorit rrjeshtor, ndërsa dhjetëshet e tjera kanë formën e numërorëve themelorë: *i tridhetetreti, i njëzindësti, nimienançindekatërdhjetenishi*.

Numërorët që tregojnë barazim mënyrën e rradhitjes së gjasendeve ose frymorëve: *dy ka dy, tre ka tre, katër ka katër*. Nganjëherë tregohen forca të barabarta: *dy me dy, tre me tre, katër me katër*.

Numërorët tregojnë edhe mënyrën e ndarjes në pjesë të barabarta të një objekti: *e dafti n'ndyzash, n'trizash*. Numërori *n'dyzash* shpreh edhe dyshimin, gjenden shpirtërore të shqipfolësit: *jom n'dyzash, m'u ka da menja n'dyzash*.

### Folja

Sistemi foljor në këtë të folme karakterizohet me trajta të laryshta duke u larguar nga mbarë të folmet e tjera shqipe e konkretisht nga të folmet fqinje të Moravës së Epërme, Gollakut dhe të Moravicës. Dallimet kryesore nga gjuha letrare dhe të folmet e tjera më tepër i ndeshim në: *imperpekt, aorist dhe futur*, ndërsa kohët e tjera nuk ndryshojnë aq sa që të mund të bëhet fjalë veçmas për to, andaj unë do të sjellë shembëlla për tiparet dalluese të kësaj të folmeje. Më parë të shohim konkretisht fizionominë e imperpektit. Imperpektit sigmatik në vetën e parë të njëjësit përveç foljes që zgjedhohet

i ndajshtohet edhe një *n*: *punojshna, shkojshna*. Ndërsa vetja e tret i përngjet admirativit të imperfektit, duke marrë mbaresën *-jke* në vend të *-nte* ose *-te*.

### Imperfekti

Njëjës	Shumës
<i>punojshna</i>	<i>punojshmi</i>
<i>punojshe</i>	<i>punojshe</i>
<i>punojke</i>	<i>punojshin</i>

Foljet e parregullta: *me pā, me rā, me ndējt, me ārdh*

Njëjës	Shumës
--------	--------

1. Unë pāshna, pāsha (pājsha), rāshna, rāsha (rājsha), nejshta, ardhshna	pāshmi (pājshmi), rāshmi (rājshmi) nējshmi, ardhshmi
2. pashe (pājshje), rāshe (rājshje) nejshe, ardhshje	pāshi (pājshi), rāshi (rājshi), nejshe, ardhshje

### Aoristi

Gjatë shekullit XVII në trevat qendore të gegërisë filluan të paralajmërohen novacione të kontraktionit vokalik *ae* në *e* dhe *oe* në *e*, forma të cilat më vonë i përqafoi edhe gjuha bashkëkohore letrare.<sup>46</sup> Grupi *ae* në viset veriperëndimore ka dhënë më shpesh *ā, dhā* (dhae), *nā* (ngae), në anën verilindore më tepër ka dhënë *ā*: *thā* (thae), *dhā* (dhae), kurse në Gegërinë jugore ka përfunduar në *ē*: *nē, dhē, thē, ngē*,<sup>47</sup> ndërsa në të folmen e Moravës së Poshtme ashtu si edhe në të Epërmen ruhet faza e parë *ae*: *ngae, thae, rae, pae*, etj. Pra *ae* ruhet në vetën e dytë të aoristit sigmatik.

Njëjës	Shumës
1. <i>pāsh, rāsh, nējta</i>	1. <i>pām, rām, nējtēm</i>
2. <i>pae, rae, nejte</i>	2. <i>pāt, rāt, nējtt</i>
3. <i>pā, rā, nējti</i>	3. <i>pān, rān, nējtēn</i>

Në disa fshatra të Bujanovcit (Tërrovoc) folja *me ndejtē* në aorist bën: *rrijta, rrijte, rrijti, rrijtēm, rrijtēt, rrijtēn*. Po kështu edhe futuri bën *do të vijm me rrijt* (të vend të *vijm me nejt* siç bën në të folmen e Moravës së Poshtme).

Në këtë të folme foljet me diftongun *ie* që dha *je*, në aorist dalin në *o*, herë mbeten ashtu me *ie, je* ose e shndërrojnë në një *i* të gjatë. Për shembëll: *pfjeka, mjela, xhega, njeka, hjeka mjella (milla) sjella (silla), çërta (tira) në*

<sup>46</sup> Eqrem Çabej, *Buletini i Universitetit shtetëror*, nr. 3, 1958, 14-15

<sup>47</sup> Jorgji Gjinar, *Dialektologjia shqiptare*, Prishtinë, 1970, 41.

vend të trajtave të drejta të mbarë shqipes: *poqa, mola, dogja, ndoqa, hoqa, mbolla, solla, tora.*

**Prezenti.** — Edhe prezenti mund të shprehë futurin, për shembëll: *po shkoj për dru nesër, nesër po shkoj n'mulli, po shkoj n'pazar.* Në këtë rasë po mos t'ishte ndajfolja e kohës *nesër* veprimi kuptohet se është duke u kryer tani për tani kur jemi duke folur. Sipas mendimit tim në këtë të folme dallojmë dy prezente:

1. *Prezenti i ngushtuar apo i kufizuar* në një interval kohor shumë të shkurtër (prezenti sekondar) që kryhet në momentin kur është duke folur shqipfolësi: *qe po vij me ni here, po vjen çetash.*

2. *Prezenti i zgjeruar apo i vazhdueshëm.* Me këtë prezent shqipfolësi kuptimin për kohën e tanishme nuk e ka thurrur e ngushtuar në një interval kohor sekondar, por e ka zgjeruar në një interval kohor më të gjatë, të vazhdueshëm. Duke shprehur sezonën e punëve bujqësore si gjithënjë flet me një prezent të zgjeruar, për shembëll në sezonën e të mbjellave, të mihjeve, të korrave, të vjelave, etj. ai thotë: *jemi tu prashit, tu mjëll, tu korr.* Nëse bëhet pyetje: *shka do të bëjmë nesër?* bujku përgjigjet: *po mjëllmi, po prashitmi, po korrmi,* e nuk thotë: *do të mbjellim, do të prashisim, do të korrim* e as *kemi me mjëll, me prashit, apo me korr,* sepse punët sezonale në një interval të caktuar kohor ai i hedh në plan të parë, andaj gjithnjë flet në kohën e tanishme gjër sa t'i kryejë punët e një kulture të caktuar.

Prezenti në mënyrën imperative bën: *kërkoe, çoe, paloe, knoe, kërkone, çone, palone, knone,* pa konsonantin antihiatizues (khs. roe=roje), dukuri të cilën e gjejmë te Buzuku, *gjykoë, qërtoë* (khs. me turq. seir, daire=sehire, dajre).<sup>48</sup>

**Futuri.** — Në këtë të folme si në mbarë gegërishten dallojmë dy forma futuri: 1. *Futuri i domosdosë* dhe 2. *Futuri volitiv.*

1. *Futuri i domosdosë* — ky lloj futuri është në përdorim më tepër se sa ai volitiv, jo pse tregon një varfëri gjuhësore, por shpreh një veçanti detyrimore të shqipfolësit. Me futurin e domosdosë shprehet një detyrë, obligim që duhet kryer pa tjetër apo që pret të kryhet duke ndërë një nevojë imperative. Për shembëll *nesër kemi me shkū për drū,* shqipfolësi ka vendosur për një aksion të tillë dhe nësër pa tjetër do ta kryejë këtë obligim që i ka parashtuar vetes. Ose: *N'mot kemi me mjëll ma shum grūn se kallamoç, se krahi i ka çillū çashtu.* Pra ky shembëll shpreh një detyrim imperativ të domosdosëshëm, të kushtëzuar edhe nga rregullat e kushtet imponuese të kulturave bujqësore, sepse ndërrimi i tyre për çdo vit në fushat e punuara sjell rendimente më të larta, prandaj shqipfolësi me vetëdije të plotë e dallon futurin e domosdosë nga ai volitiv, në të folurit e përditshëm duke i përcaktuar detyrat dhe obligimet e veta më me veçanti shprehëse. Kjo nuk do të thotë se atij i mungon futuri volitiv, por këtë do ta përdorë në një kuptim tjetër me të cilin nuk shpreh detyrim, por dëshirë, vullnet për një punë që do ta kryejë në të ardhmen.

<sup>48</sup> E. Çabej, *Hyrje në Historinë e gjuhës shqipe*, fq. 140.

2. *Fluturi volitiv* — i ndërtuar me pjesëzën *do+të* dhe foljen në indikativ të prezentit ka kupimin e një të ardhme më të largët dhe puna që duhet kryer qëndron në një shkallë më të ulët detyrimi, duke ju shtruar stihisë së dëshirës, vullnetit dhe mundësisë e rrethanave reale. *N'mot do t'mjellim bostan*, në këtë fjali shqipfolësi ka shprehur më tepër një dëshirë, vullnet, i cili mund të realizohet varësisht nga vullneti i tij për punë, nga mundësia dhe kushtet reale. Këtu nuk kemi ndonjë detyrim imperativ. Me futurin volitiv shqipfolësi i kësaj ane shpreh: *dyshimin, hamendjen, shpresën për një punë që do të kryhet në të ardhmen*: 1. *Nuk di shka do t'bon xhali, a do t'kalon sivjet ajo? Do t'i del puna hardall. I kom hi ni pune po s'e di a dot'i dal n'kryt! Hasanit do t'i bôhet sarp ni xhâl.* Këtu shprehet një supozim lidhur me formimin e personalitetit në të ardhmen e një personi të caktuar.

Maxhetorja, kur nuk ka bukë, parashtron detyrën e saj se duhet të gatuajë me këto fjalë: *Sod kom me gatû se s'ka mët fija e bukës*, ndërsa pas saj shpreh dëshirën, vullnetin apo mundësinë reale me këtë fjali: *po nuk do t'gatuj se jom e lig pi krës. Hasimi ka me mjëll sivjet shum se i ka arat për grûn, po nuk do t'i mjell, do t'i jesin shêrpi, se ska me shka me livrû, ka mët pa kije.* Ndodh që futuri volitiv të zëvendësohet edhe me futurin e domosdosë, por të shumtën e rasave këta dy lloj futurash përdoren me një vetëdije të plotë qëllimore dhe veçanti gjuhësore. Është krejt gjë tjetër që të folmeve toske u mungon futuri i domosdosë.

Folja *me pasë* në kohët e përbëra shprehet me *jom*, p.sh.

<i>jom ardh</i>	<i>jena ardh</i>
<i>je ardh</i>	<i>jeni ardh</i>
<i>â ardh</i>	<i>jan ardh</i>

Ndërsa konjuktivi në vetën e tretë të njëjësit nuk përdoret, por shprehet me fizionimi të indikativit: *le t'vjen, le t'shkon, le t'mson* (në vend të: *le të vijë, le të shkojë, le të mësojë*).

### Ndajfoljet

Pjesa më e madhe e ndajfoljeve të kësaj të folmeje janë të përbashkëta me të folmet të tjera, por unë do të përmend ato që janë më karakteristike për këtë të folme.

Ndajfoljet e vendit — *këtu, khô, açe, knej, anej, knena, anena* (*Hec knena mos shko anena*), *kësajde, kasajde* (*Ma mir shkojmë ksajde se asajde ka thërra*). Ndajfoljet edhe pse janë pjesë të pandryshueshme të ligjëratës, shpesh na paraqiten me fizionomi të substantivuara si: *Pi açehit, pi khôhit, ktuhja, khôja, açehja, çaty, çetu.*

Ndajfoljet e kohës — *sod, nesër, pak ma parë, parza* (pazra), *xhé, kërr. Sodja kurr nuk bezenis me nesren. Dita e sodit shkoj huç. Me sodën i paçim prish pünt. Dita e xhehit nuk kthehet mâ, ajo ka shkû. Me xhehen u kry ajo pûn.*

Ndajfolje mënyrë — *mirë, keq kështu, ashtu, dyçyshme, kurrçyshma (paj sa me thanë pi kurrçyshes n'dyçyshë). Kjojha, çekjohja, çajohja, (Se m'xhon çekjohja tybe n'e paça dit. Hiç mos u tut se çajohja ka me t'xhët. Çekjohja ka me na xhët krejtve (kejtve), kush ka le s'â çare pa dëk).*

Ndajfolja e mënyrës ndërtohet duke u përsëritur emri: *ish shkÿ, ish bâ copa - copa. E kish ble ni fustan vija-vija. E kish mjell kallamoçin rena-rena. Ra prej s'nalti e u ba pik-pik. Dynjaja âshte shkallë-shkallë. Mos e bon punën shkel-e shko. Mos e thirr sa për sy e faqe. Ê thirra sa me la gojën. Fola me maje t'gûhes. Hove-hove, hân-hân, etj. Duke u përsëritur fjalët e huaja: turli-turli, çeshit-çeshit, homle-homle.*

Ndajfolje sasive — *shum, pak, çekaç, çaç, sa t'zit e thonit, sa çon miza n'krah, sa zerrja nuk m'ka nimu. Çaç ka n'dôr. Ndajfoljet shum, pak mund të paraqiten edhe si emra: pakicë -a, shumicë -a. Si mbiemra: e pakta, e shumta. (E shumta e mun t'pakten).*

Ndajfolje pohimi — *po, ani, anipra, anide, pode, anishka. Po, une i thash. Tha ani le t'vin. Anishka se m'ka sha, aj ashte thmi e s'ka kusure.*

Ndajfolje mohimi — *jo, mo, mos, kurr z'bôhet, mozomoqeç, Zoti mos thasht, runa zot, kurr e për jet, sod e niçin vjet, kur t'ban shelnja rrush, toka m'u praptu, mu ba dynjaja dy, etj. Ndajfolje kësisoji shprehin vendosmëri, kryefortësi dhe negacion, duke shprehur mohimin në bashkëbisedë me folës të tjerë.*

Ndajfolje dyshimi — *pale-pale, ta shohim, ta kqyrim, nashta, ashtu - kshtu, as po as jo, po-jo, jo-po, n'dyzash, n'dy mene, shybeli, pishmanash, etj.*

Parafjalë — *pi, me, tej, teri, njeri, për, nëpër (napër). Mos hin napër lluga! Parafjala veç, ndëgjohet viç, viçse, mirpo te, tu, tuk, tu (e), porsa. Parafjala tuk nga njëherë zëvendëson ndajfoljen e kohës thuhet ham-ham, për shembëll Tuk e pash e dita pse ka ârdh, ka kuptimin kur e pash ather m'ra ndërmen. Tuk t'pash m'ra nërmen ç'i t'kom borç.*

Lidhësa — më të shpeshta janë: *sepse, edhe pse, masi, misi, mise, dhe, edhe, çimçi, ai, e të gjera. Erdh masi e thirra. Misi ja dhash fjalën z'bojke me trathtû. Mise (lene qe) ke that me ni ân edhe breshën ra n'ket ân. Kti ç'i i thash aj nuk erdh po erdh ni çeter. Çimçi (se) jom kon n'zôr për tÿ. Shumë shpesh përdoren edhe këto lidhësa: hem-hem (nga një herë thuhet ham-ham. Ham lypke ham s'e dojke un s'i rash n'fije atij, ja - ja (ja ngrihu ja grahu), hot-hot (Hot për t'mir hot për t'keç çaty e ki, i joti asht s'ki ku e çon), as-as (as s'po des, as s'po çohet, na la muhasere).*

### Fjalëformimi

Në fjalëformimin e përditshëm janë të përhapura prapashtesat: *-an, -ar, inë, -isht, -sufiksi sllav -icë, dhe sufikset turke -çi, -xhi, -ler, -llar, -llak e të tjerë.*

Me sufiksin *-lec*: *aralec, kodërlec*, (Përlepnicë).

Me sufiksin *-an*: *rrudhan, gulan, çyçan, shulan, shurdhan, kuçan, parllapan, dredhan*, etj.

Me sufiksin *-ar*: *xhahtār, katunār, pisār, govedār*.

Me sufiksin *-tore*: *maxhitore, fshisatore, nimatore, tamëltore*.

Me sufiksin *-aç*: *fikaç, dredhaç, nyllaç*, që kanë kaluar në ç: *fikç, dredhç, nyllç*.

Me sufiksin *-in*: *lakshin, lloçkovin, torllovin, stërvin, shiovin, llomshtin, vjetërcin, egërcin, cofin, tershovin, kushovin*, etj.

Me sufiksin *-icë*: *sakic, baçic, ngallic, pakic, shumic, ngushtic, malic*. Me këtë sufiks janë të formuar një mori emra fshatrash: *Përlepnic, Topanic, Kopërrnic, Rogoçic*, që kanë prapashtesë të huaj.

### L e k s i k u

Një kujdes të veçantë meriton t'i kushtohet leksikut të kësaj të folmeje, pasi këtu gjejmë fjalë që nuk përdoren në të folmet e tjera të krahinës e ndoshta i mungojnë edhe mbarë shqipes, si gjuhës së folme si asaj të shkruar. Unë po sjell këtu më poshtë një grup fjalësh të cilat më duken se janë të rralla në të folmet e tjera:

*Bakrāç-a*, f. = vorbë-a, poç.

*Cigëll-a*, f. = një lloj shpendi i zi i cili duke lëvizur krahët qëndron në ajër. Banorët e kësaj ane mendojnë se ky shpend sjell shi. Prej vezëve të tij çelin skyfterët.

*Cipridoncullak* = lakuriq, i zhveshur.

*Çokmalok* = një lloj loje e fëmijëve të ndarë në dy grupe. Njëra palë mëshihet, pala tjetër mundohet t'i gjejë. Morava e Epërme këtë lojë e quajnë *çokorrok*.

*Çatal-i*, m. = dru trekëmbësh që përdoret në mbathtari.

*Firë-a*, f. = mbeturina që mbesin gjatë pastrimit të grurit. Fig. *aj asht njeri pa fira* (pa të meta).

*Fillkeç-i*, m = njeri qëllimkeq.

*Fillkallidon* = i vetmuar, pa kurrkend afër. *Meta n'mal fillkallidon*.

*Furdë-a*, f. = mbeturina që mbesin gjatë palimit të duhanit.

*Fullumuç-i* = lësh, truç, grumbull, pa rregull.

*Garramel-i*, m. = një dru i ngulur në dhë, i gjatë 2 m. në maje të të cilit horizontalisht vihet një dru tjetër i përforcuar për drurin vertikal, ku luajnë barijtë duke u sjellë ditën e Shëngjergjit (toponimi: Fusha e Garramelit).

*Me gorrunele* = plot e përplot. *E pruni ni tavë me gorrunele dardha*.

*Garramet-i* = Mundim, punë e mundimshme, *garramet i madh*.

*Gozhdar-i* = kunji me të cilin lidhen dy kutat (harqet e rrotës së qerres). Morava e Epërme i thonë *myzhdenjak*.

*Giligajk-a*, f. = Shkopinj në trajtë kërrabe me të cilat luajnë fëmijët duke ecur me to.

*Grezin -a*, f. = kashta e mbetur në grazhd të kafshëve.

*Gulan-i*, guluj -a m. = kã i plak e pa dhëmb, *i kom ble ni pën kije guloja*.

*Grahuç* = poroz, *milli grahuç*.

*Gërzhit*, fol. = *â gërzhit duhani*, është tharë për së tepërmi, nuk mund të bëhet punë. Fig. *filani nuk po gërzhitet për at punë*, nuk po ka dert.

*Guxhar-i*, m. = i thonë lojtarit i cili në lojë e *guxhave* i grah guxhës (një copë cung i rrumbullakësuar).

*Hazne-ja*, f. = pjesa e hekurt që i vihet rrotës së qerres.

*Hondrak-i*, m. = mbeturina bimësh të ndryshme, papastërti.

*Harvallin-a*, = diçka e madhe pa ndonjë harmoni simetrike, *ish një grua harvallin*.

*Hosh* = i *erdh hosh*, i erdh mirë, ia kënda një gjë qelepir.

*I hergatum*, mb. = njeri i rryer në punë, njeri i *hergatum*

*I lloçkaft*, mb. = bukë e papjekur mirë, *ish bâ buka llōçk*.

*Kërçel-i*, m. = mjet i parmendës, fig. *filani âasht kërçel*, kërçaman, i aftë, i gjendshëm, që futet ku është më vështirë

*Kōp-a* f. = dhjetë duaj misri që vihen në arë për të mos u kalbur nga shiu.

*Kërstin-a*, f. = nëndë duaj gruri të tubuar (Morava e Epërme i thonë kryzë-a, kryzqzë-a).

*Kūt -a*, f. = harqet e rrotës së qerrit, gavejt.

*Krasat* (kracat) ose sjetllat e kerrit = krrabat e qerres së mbrame.

*Kllaposh -i*, m. = njeri me vesh të mëdhenj, qeni me veshë të paprerë.

*Laūr -a* = trinë, zastoje, shtek për të kaluar.

*Lëjk -a* f. = pocërck, shërben për t'u larë, duke zëvendësuar tasin.

*Livriçk -i*, f. = njeri ngucakeq, që s'rrin urtë, që nuk zen vend.

*Lezhgavinë -a* f. = rrugë rrëshqitëse, rrugë me baltë, e lagur nga shiu, posa ka rënë shi.

*Llastar-i*, m. = filiz, pip, sharmend një vjeçar.

*Lluçk-i* m. = grykës, njeri që han shumë.

*Lloçkovinë -a*, f. = shi e baltë, rrugë e përbaltur tepër.

*Me kinū rrushin* = kij rrushin, prej rrushin.

*Maternik -i*, m. = dhjetë brazdë të kopshtit të ndara veç e veç thirren maternik.

*Malic-a*, f. = viç të cilin lopa e ka pjellë në mal.

*Mushtrak-i*, m. = papastërti, mbeturina gjithëfarësh. *Ish mush oborri plot mushtrak*.

*Pöllz-a*, *bollza* = bollzat e sajës.

*Pitillak*, = një lloj loje që luhet me pllaka.

*Pekardhi*, *pallapeda*, f. = lojë me shkopinj, duke përshkuar shkopi-shkopin rrëshqanas.

*Përshtruse*, *peshtrose*, *poshtrose*, f. = plunga në të cilat vihen bukët mazdore.

*Paprric -a*, f. = kutlla apo shiniku i mullirit.

*Pushkäll -a*, f. = një lodër fëmijësh e bërë prej shtogu.

*Pregel -i*, m. = mjet për të gjetur mesin e gavellit të rrotës.

*Pallangoz*, *pangalloz*, -i, m. = njeri i pagdhendur, i paedukuar.

*Puri -a*, f. = pjesa e hekurt e gavellit që e mbështjell osin e qerres.

*Proja e osit* = një copë hekur që vihet në mes të jastikut e osit të qerres.

*Razūr -i*, m. = disa maternikë përbëjnë një razūr.

*Rropoçuk-i*, m. = njeri i shkurtër nga shtati, jo i zhvilluar, pak si i mbledhur.

*Rrmök-i*, m. = njeri i vogël nga shtati, por i aftë për punë, i shkathët.

*Rrumudā jk -a*, f. = një lloj loje e barinjve, duke kërcyer shkopijt.

*Rrufat-a* f. = dru të thata, krande të thata, të cilave kafshët ia kanë ngrënë gjethet.

*Rrepilli* m. = rrebull-i (një lloj sëmundje e lëkurës).

*Sorrz-a* f. = biga e sajës.

*Svraka, suraka*, ose *sorra*, f. = një lloj loje e barinjve duke i gjuajtur shkopijtë në ajër për ta përshtuar shkopin e hedhur më parë.

*Stërvin -a* f. = kashtë, sanë e shpërndarë që e marrin nëpër këmbë kafshët. *I kish ba uki dhent stërvinë*, i kishte mbytë e lënë të ngordhura.

*Sllupc-i* m. = kamëz e karrocës.

*Shlakavicë -a* f. = një e sjellë e shuplakës. *Ja dha një shlakavicë ftyres.*

*Shupüll-a* f. = shuplakë -a.

*Shileg-i*, m. = qingj një vjeçar.

*Shkëk-a* f. = xhepa, fig. e *bani shkëk*, e bëri punën tollovi.

*Temlik-i*, m. = kular -i.

*Talig-i*, m. = një lloj druri, bung i bardhë. Zakonisht rritet në hije, prandaj nuk ndezet mirë dhe nuk bën prush. Përdoret për kunja qerresh, sepse është i fortë.

*Tarapushkë-a* f. = një lloj loje barinjësh (shih rrumudajkë-a).

*Tërrinjak-i*, m. = fundi i boshtit kurrizor.

*Xivonë-a*, f. = zile bagëtish.

*Xërxtatë*, fol. = me ngacmua dikend, me xërxtatë.

*Zangoç-i* m. = qen bredhës.

*Xhini-ja* f. = kënd i cili shërben për të prerë drejt dërrasat në zdrukhtari.

## Sintaksa

Ndërtimi i fjalisë bëhet sipas rëndësisë së ngjarjes, në ç'vend e kohë e prej kujt kryhet një punë. Theksi në fjali bie mbi fjalën kryesore të saj duke shtuar me një ngjyrë zëri të veçantë nga fjalët e tjera. Edhe pse fjala kryesore, për të cilin flasin se sipas rradhitjes duhet të vijë në mes apo në fund të fjalisë, kjo fjalë shqiptohet në fillim. Shqipfolësit nuk i intereson rradhitja e pjesëve të ligjeratës në fjali, por ai rradhitjen e fjalëve e bën sipas rëndësisë së bisedës së tij, sipas rëndësisë faktike. Shqipfolësi ndërton fjalinë: *Ka ra shi sod, Grunajet sivjet jan shumë t'mira?* Për shqipfolësin fjalët kryesore janë *ka ra shi* dhe *grunajet*, ndërsa një intelektual do të ndërtonte fjalinë në këtë rradhitje: *Sot ka ra shi, Sivjet grunajet janë shumë të mira*. Në biseda të gjata kryefjala mungon në çdo fjali, sepse dy bashkëbisedues që në fillim kanë përcaktuar kryefjalën, prandaj e tërë biseda zhvillohet në fjali të varura edhe pse kjo bisedë zgjatet tepër e merr formën e një tregimi, duke pasur si shtill kryesor kryefjalën në fjalinë e parë. Kështu që një i tretë vështirë e ka të zërë fillin e objektit për të cilin bisedohet. Për shembëll: *N'Pusto Rëk e ka zon njeni ni rob t'ni katuni çeter. N'Pusto Rëk është plotësor vendi*, por pasi ngjarja zhvillohet në këtë fshat shqipfolësi i Moravës së Poshtme që në fillim ka vënë gishtin mbi këtë

fjalë, duke theksuar në ballë të fjalisë. Fjalitë mungesore janë shumë të shpeshta. Qytetarët që merren me bujqësi kryefjalën shpesh nuk e theksojnë duke lënë që ajo të kuptohet vetvetiu, për shembëll kur do të shprehë shpenzimin e ushqimit të kafshëve bujku—bujkut i thotë: *E hangrëm detelinën krejt e kashten s' pe ham*. A hanë njerëzit detelinë e kashtë? sigurisht jo. Pra, kryefjala është *kafshët*, e cila në këtë rasë mungon. Në valën e punëve sezonale fshatari i kësaj ane thotë: *U korrën grunajet, u korr fusha, u fshinë lammajat, Koka livru fusha, s'paska met ar pa u livru*. Këtu kryefjala do t' ishte: *fshatarët, bujqit i korrën: grunajet, i fshinë lammajat, e lavrën fushën*.

Fjalitë këpujore janë të shpeshta. Këto lidhen me lidhësat: *as...as, e, edhe*, e shumë rrallë me lidhësen *dhe*. *As s'hangër as s'pini pi idhnimit. Edhe s'ka kaçik edhe rroket me xhihkonin*.

Fjalitë ndasore: karakterizohen me lidhësat më standarde: *ja...ja, hot...hot, apo, ndash, si...si. Ja punë si duhet ja mos punë hiç, apo shkon apo rrin. N'dash rri, n'dash shko. N'dash bjer, n'dash çu*.

Fjalitë kundërshtore: përcillen me lidhësat: *po, mirpo, për inat, për çef, kurse, etj. I shkreti u munu boll, po s'çiti kurxhâ n'drit. Une i thash mos puno kshtu, aj për inat tem punoj ndryshe. Une e thirra po aj s'erdh. Lidhësat kurse dhe mirëpo, janë bërë aq të shpeshta tek brezi i mesëm dhe i ri sa që po përdoren edhe atëherë kur nuk kanë funksion të negacionit. Përshembëll: Une e thirra, mirpo edhe aj ish çu e erdh*.

Fjalitë përmyllëse: *pra, prane, edhe. Ke fol përpara, pra tash baje. Ka punu Erifi edhe ka fitu*. Disa fjali përmyllëse nuk lidhen me kurrfarë lidhësash, por ndahen vetëm me presë: *Çysh t'ja bajsh, ta ban. Si baba, i biri. Si saçi, tepsija. Si nusja, kerri*.

Fjatitë përjashtimore: ndiqen nga lidhësat: *veç, veça, viç, viçse (veçse): Krejt kën n'darsum veç Hasanit*.

Fjalitë e varura: Tek fjalitë e varura kohore ndeshim lidhësat: *kur, tuk, veçsa, terisa, masa, kurdohër, sahër çu. Veçsa u unxha (unja) ti ja mrrine. Kur t'pash e dita pse ke ardh, e të tjerë*.

Fjalialia qëllimore (finale): në këtë të folme ndërtohet me infinitiv. *Për me pās pasuni duhet me punë. Për me kry shkoll t'madhe duhet me msu shum. Sonte po vīm me nëjt*. Në këtë të folme nuk ndeshim fjali qëllimore të shtjellura të krijuara me lidhësen *që*, por vetëm fjali qëllimore të pashtjellura me paskajoren e zakonshme ose me paskajoren e ndërtuar me lokucionin *për me: Kam ardh me u përta me ty, kam ardh n'pazar me ble ni lōp, por edhe: kam ardh për me blē ni lōp*.

Fjalitë dyshimore (dubitative): Përdoren kur shqipfolësi shpreh dyshim ose pasiguri, duke ja tërhequr vërejtjen bashkëbiseduesit të tij. Lidhëzat më të shpeshta për këtë lloj fjalie janë: *mos, se mos, po tremna, po tutna, kam dro, ruju, jam n'dyzash, jam n'dy menesh, etj. Kçyr mos po sharron se koka fëll. Jam n'dyzash s'po di shka me bō*. Fjalialia dyshimore është një farë e fjalisë kundrinore, ku shfaqet dyshimi; *Kçyr mos po habitesh*.

Në këtë të folme ndeshim shpesh herë konstrukte të fjalisë në të cilën nuk përshatet numri i kryefjalës me kallëzuesin si: *T'vögllit i hân (i hâjn) mollat, t'mdhajve ju pthen dhôm. Me xhin t'egër mos paç punë. Klysht e vögël lypin tomël. I kom thmin e vögël. Ftojt e egër jan ma t'shishum se t'butit.* Pra, si shihet në këto shembëlla kryefjala është përdorur në numrin njëjës e kallëzuesi në shumës. Në vend që të thuhet: *të vegjël, të egjër* është përdorur mbiemri në njëjës *të vögël, të egër* e të tjerë. Tek brezi i mesëm dhe tek brezi i ri, madje edhe te intelektualët shumë fjali janë kalke nga gjuha serbokroate, e cila ka ushtruar një ndikim të madh si gjuhë zyrtare e shtetërore si në të kaluarën poshtu edhe sot. Në këtë të folme ndëgjojen fjali të ndërtaura më këtë mënyrë: *U b ô zôr me ardh teri te dinari. More zor e kom teri t'vi n'ven se si t'um vjen reni s'kan ku m'çojn. Çetahi u bo zôr me hi n'shköll se poj lypin ma t'mirt. U bo zôr me ardh teri te buka.* Ndërsa tek brezi i vjetër ndëgjojmë: *Sod u bo zor me fitu dinarin, ose u bo dinari sa rrota kerrit. U bo zôr me fitu bukën. Çetahi u bo zor m'u shkru n'shkoll se poj zgedhin ma t'mirt.* Kalket nuk kanë depërtuar tek plakat sepse ato nuk flasin të tjera gjuhë pos shqipes, mirëpo me to më pak kemi zhvilluar biseda.

### T e k s t

N'Pusto Rek /e ka zôn njeni ni røb//i ni katuni/ n'çëtrin katun//e dâjn vâden n'cillen dît me bô darsum//At dit çu i bô darsmja) u çu ni ûj i madh /e sun pi bin ujt me dâl//E çun robin te reka/ po ish ujt e madh/e deshtën m'u kthy//Çika priti e foli: ni hër kom le/ ni hër kom me dek/ ni hër jom bô nuse/ /une s'kthehna teprap/ veç amnâ ni kali /i e ka ra ujt//ka plivât kali edhe e ka çit n'at ân shnôsh'e mîr//At-her shkûn me xhymysh//shnôsh'e mîr//N'dy ân krisën pûshkt pi gximit/

/Ni domaçin i ka martû dy xhëm per ni dît//edhe i bîn te shpija nûset/ /edhe i shtën secilli nuset//n'sôb t'vet//Si i bîn//t'fillohen me shkû me ngâ n' ykdÿl/ n' ykdÿl krejt mashqit//Mirpo açe rroken nermiveti /e sun raziten/e kërset pushka nermjeveti//plagohet dikush/ e vrahët dikush /E shka me b ô/ grât dalin n'aborr tu kukât /nuset i lân vëtum n'soba/ Nusët kur shohin çu meten vëtem//fët njona / fët çëtra//dalin n'çardak//me kçÿr çu i bô nomi/ /Kur kthehen krushçit/ nuset hinën n'soba /e xhathta hini n'shmâjtÿ e shmajta n'xhâtÿt /e metën çatÿat nât/ Shkûn xhëmt /e hinën dhandër//Tu besedu me çiken/ e tu vet /at-hër po u ep xhevap çika /un nuk jom e filanit/ po jom e filanit /edhe çëtra thot/ une nuk jom e kujna po kujton ti//e at-her u mûr vesh/ çu i ndrûn /kta edhe hin n'xherdek çashtu/ at-her dûlen xhëmt /i thirren print /e i than/ /çu i bô dallashllak//çÿsh me ja bô/ at-her /shkojn e veten shehrijatin /e kadija i dhâ xhevâp /çëter â nijeti /çëter â kysmeti /çÿsh kan fjët//çashtu ka me mét/

/E mûr e çoj çiken te aj ashiki/ /i rrehi n'der/ dûl domaçini /e shtëni mrenda/ /kur hini mrenda/ ky xhali pe vet plakin /ku i ki xhëmt//aj thot /fjëtum//ky i thot/ çoe filanin /le t'vîn ktu//edhe e thirren/ e aj xhali erdh//e mûr ashiken e vet nuse/ u çu baba i kti xhalit/ ja dha kti çiken e vet//çashtu burrat kanë punû /me bës kân errnû/

Mehmet Halimi

## DU PARLER DE LA BASSE MORAVA

### R é s u m é

L'essentiel de notre travail est de présenter un exposé sur les traits caractéristiques du parler de la Basse Morava en l'opposant à celui de la Haute Morava du fait que des traits communs de langage caractérisent les deux secteurs linguistiques. Notre étude fera ressortir les concordances de différentes formes morphologiques et aussi une comparaison entre les différences essentielles de ces deux parlers.

### Phonétique

**Les voyelles** On distingue dans ce parler trois espèces de voyelles: longues, moyennes et brèves.

*Les voyelles longues:* kalā, vllā, belā, dhē, fē - ja, shpī, rini, möll, shköll, i höll, böll, pül, ür, me müsh, ftÿr, ynÿr, shpÿrt.

*Les voyelles moyennes:* mali, kali, feja, dhevi, beja, pisha, shpja, çiknija, toka, vorri, morri, lugi, pllugi, fusha, tlyni, dryni, syni.

*Les voyelles brèves:* mäl, pläk, xhäk, vén, çën (vënd), près, shës, fis, mik, fiç, zög, shtög, mörr, võrr, lüg, jüg, knüs, myk, klÿsh, fÿll.

**Les diphtongues** ae, oe sont bien conservées. Exemple: pae, thae, rae (la deuxième personne de l'aoriste), alors que l'oe est gardée dans les mots: droe, voe, aussi qu'à la 2 pers. de l'imp. knoe, kerkoe, paloe.

**La nasalisation** — est aussi bien présente à un degré élevé: me fshā, zā, mullā, frē, pē, me fshī, me u shtrī, mullī, drū, hū, sÿ, drÿ, me u frÿ, et d'autres mots aptes à la nasalisation. La nasalisation d'après l'analogie: kacī, thmī, mī, flī.

### Les consonnes

Dans le système des consonnes de ce parler c'est le phénomène de manque des palatales molles *q, gj*, qui est le plus caractéristique; ces dernières *q, gj* étant devenues fricatives *ç, xh*. Par exemple: çen, çurshi, pleç, xhāth, xhak, xharpën. (*ç tj; xh dj* exemples: açe, çeter, çerr au lieu de atje, tjetër, tjerr -i; xhāl, xhāth, xhe, xhep au lieu de djalē, djath, dje djep).

Dans ce parler on remarque aussi l'inflexion des: *h* en *f*; *f* en *th*; *nj* en *gj*. Par exemple: *e njoh*, mais *e njofta*, *i njoftum*; *thmi* (fëmijë), *ufëll* (uthull) *i fell* (i thellë), *ngj nj = u njta*, *njeti* (u ngjita, ngjeti), *Ara e Anjellkit* (*Ara e Angjellkit*) etc.

Le groupe de consonnes *mb* ne se maintient en aucun cas. On dit: *masi, mrena, me māj*, *me mēt* (*mbasi, mbrenda, me mbajt, me mbetë*). Pourtant le groupe de consonnes *nd* est maintenu partiellement: *ven -i, ves -i, nān* (on dit aussi: *vend -i, send -i, nandë, vendim, mendim, mendoj* etc).

Les anciens groupes de consonnes *kl. gl.* se sont réduits en *k, g*. Exemples: *me kōn, kēp, kūsht, me kāj*, *gūh -a, i gāt, gūni*.

Le *vn* slave est présent dans la deuxième de même que dans la troisième phase de son évolution: *Ramnishtë, Gllamnik, Sllamnik, Gumnishtë; Ramabuç, Ramabaj, Ramidej, Ramisht*.

**L'assimilation** est un phénomène linguistique qui se présente bien souvent dans ce parler; en particulier l'assimilation régressive de consonnes. Exemples: *i lakt, i elpt, i kelpt, i belp, i dopt, i shurth, shtatthët*, au lieu de: *i lagët, i elbët, i kelbët, i belpët, i dobët, i shurdhët, shtatdhjetë* etc.

**La métathèse** est un phénomène phonétique qu'on rencontre dans le langage quotidien: *me shlu* (me lëshue), *me urtllu* (me rrotullue), *hulatë* (luhatë), *kërlan* (kryclan).

**L'agglutination.** C'est par l'intermédiaire de ce phénomène linguistique que le parler de la Basse Morava s'enrichit de jour en jour. Parmi les mots agglutinés citerons: *midis* (de *mjetvis: mjedis: medis*), *tymën* (de *të hymën: t'hymën: tymën*), *sahora* (de

*sa+āsht+ora*), *shtruhërë* (de *shtru+erë*), *bukënore* (de *bukë+në=dorë*), *bukë mazdore* (de *bukë+mbas+dore*) et d'autres.

Au surplus dans le parler dont il est question, sont aussi présents d'autres phénomènes linguistiques tels que: aphérèse (*erfundì, rasula*), syncope (*shpi, shmang, tashi, shiti*), apocope (*përzo, kish, mo, mo+zo+ma+keç*), élision (*m'u habit, p'e lyp, p'i thot*), etc.

### Morphologie

Pour ce qui est de la morphologie, les changements sont moins évidents que dans la phonétique. Néanmoins ils sont bien présents dans ce parler et méritent une étude particulière. Les traits caractéristiques se rencontrent dans la catégorie du nom, du pronom et du verbe.

**Le nom** — a trois genres: féminin, masculin et neutre. Le genre neutre est en train de disparaître. Pourtant on l'entend des fois prononcé par des vieillards (et des gens âgés) de même que par les „Muhaxherë" albanais. Il est à noter particulièrement que certains noms n'ont que la forme définie. Exemple: *ni kali, ni shati, ni guri, n'detti* au lieu de: *një kalë, një shat, një gur et një dēt*. Le pluriel des noms est bien complexe; un nom faisant le pluriel de deux ou plusieurs variantes.

**L'adjectif** est également soumis à certaines règles de grammaire. Ce parler distingue en tant que traits caractéristiques, les adjectifs verbaux qui se prononcent avec une *m* finale au lieu d'une *n* (avec un accent bref et grave): *i pāsum, i dāshum, i dālum* au lieu de *i pāsun, i dāshun, i dālun*.

**Le pronom** Parmi les pronoms qui sont à distinguer en particulier ce sont les pronoms personnels tels que: *unë* (je, moi) et *ti* (tu, toi). Les pronoms cités ont un ablatif bien distinct du système de tous les parlers albanais de même que de l'albanais littéraire.

On fait l'ablatif: *pi mue, pi tye* au lieu de *prej meje, prej teje*. Le pronom réfléchi *vetë* est employé soit en fonction d'une répétition ou de mise en relief des pronoms personnels (atones-toniques) et démonstratifs, soit en fonction du pronom possessif pour les trois genres. Au lieu de dire *unë i thashë* pour mettre en relief le sujet parlant ou le sujet qui exécute une action, on dit: *vetë unë i thashë* (c'est moi-même qui l'ai dit). Comme pronom possessif: *xhal: i vet, çika e vet, xhemi e vet, çikat e veta*.

**Les adjectifs numériques.** Les adjectifs numériques ordinaux ont leurs genres comme les noms et les pronoms. Les numéraux cardinaux au contraire ne comprennent pas la notion du genre. Pourtant, les numéraux *dy* (deux) et *tre-tri* (trois) font exception.

Pour le genre féminin on dit:  
*dÿ çika, dÿ gra, trÿ çika*  
*trÿ gra, dÿ plaka, trÿ plaka*

Pour le genre masculin on dit:  
*dy xhem, dy burra, trë xhem*  
*trë burra, dy pleç, trë pleç.*

**Le verbe.** Les différences essentielles dans le système verbal de ce parler se sont maintenues dans l'imparfait, l'aoriste, le futur et le subjonctif. La troisième personne de l'imparfait (nuances admirative) se termine en — *jke*: *punojke, shkojke, thojke*, au lieu de: *punonte, shkonte, thoshite*. A la première personne du pluriel de l'imparfait (à la terminaison sifflante — sigma *sh*) est ajouté la consonne *-n*.

**Le verbe irrégulier** *me pa* (voir) a deux variantes d'imparfait: *pajsha, pajshe, pajke, pajshmi, pajshit, pajshin* et *pasha, pashe, pakke, pashim, pashit, pashin* au lieu de: *shihja, shihje, shihte, shihnim, shihnit, shihnin*.

**L'aoriste** — En ce qui concerne l'aoriste il est intéressant de remarquer un trait particulier; l'ancien aoriste qu'on rencontre chez Buzuku est maintenu à la deuxième personne du singulier: *pashë, pae, pa, pām, pāt, pān*. L'aoriste s'emploie de même sous forme de: *mjella, mjela, pjeka*, au lieu de: *mbolla, mola, poqa*, etc.

**Le futur** On distingue deux espèces de futur: 1. Le futur exprimant une nuance volitive (il ne s'emploie que rarement): désir, doute, volonté, possibilité ou circonstances réelles d'une action future. 2. Le futur exprimant un fait futur indispensable à accomplir (*Fu-*

*turi i domosdoshmërisë*) s'emploie bien souvent. Il exprime un devoir ou une obligation qu'on devra accomplir absolument ou qui est à accomplir d'une manière impérative.

Le s u b j o n c t i f est exprimé sous la forme de l'indicatif. Exemple: *le t'yjen, le t'shkon, le t'mson*, au lieu de: *le të vijë, le të shkojë, le të mësojë* etc.

Aussi peut-on dire que le parler de cette région dispose d'un fonds lexical bien riche qui s'emploie soit dans l'entretien quotidien soit dans la toponymie de ce secteur linguistique.

